

EPOKA

ERE

E përditshme e pavarur
Viti XIX, nr. 5813
E premte, 28 qershor 2019
çmimi 0.40 €

Meta cakton 13 tetorin datë të re të zgjedhjeve lokale, Rama e kundërshton



Na ndiqni edhe në:

www.epokaere.com

facebook.com
Gazeta "Epoka e re"

AWR ABRUCH GMBH
www.awr-abbruch.de

AKTUALE

BAJRAM KOSUMI RIZGJEDHET REKTOR I UNIVERSITETIT 'KADRI ZEKA' F. 8

KADETËT E DIPLOMUAR TË FSK-SË JAPIN BETIMIN PËR SHËRBIM NDAJ SHETIT F. 6

SISTEMET E AVANCUARA TË QKMK-SË MUNDËSOJNË MBIKËOYRJE MË TË MIRË KUFITARE F. 7



EKONOMI

MATOSHI: PO SHËNOJMË HAPA POZITIVË PËR KRIJIMIN E NJË KOSOVE TË GJELBËR F. 9

KRYESHEFI I TELEKOMIT: 'Z-MOBILE'-S NUK DO T'I VAZHDOHET KONTRATA F. 9

KULTURË

RRETH LIBRIT "PRERJA E FRIKËS" I AUTORIT FEHMI PIREVA F. 13



Salihe SALIHU, PhD dhe veprimtare

ARMAGEDONI BOTON MONOGRAFINË PËR DRAMAT E QOSJES F. 13

SPORT

DITË E MADHE PËR SPORTISTËT DHE ARTISTËT F. 16

GJYKATA KUSHTETUESE KA VENDOSUR NË FAVOR TË LËNDËS SË PARASHTRUAR NGA DY PARTITË OPOZITARE, LIDHJA DEMOKRATIKE E KOSOVËS (LDK) DHE LËVIZJA VETËVENDOSJE (LV)


Kushtetuesja e shfuqizon ekipin negociator të dialogut



Ligji për Detyrat, Përgjegjësitë dhe Kompetencat e Delegacionit Shtetëror të Republikës së Kosovës në Procesin e Dialogut me Serbinë është shpallur jokushtetues nga ana e Gjykatës Kushtetuese të Kosovës. Kushtetuesja ka bërë me dije se delegacioni shtetëror i cili është themeluar me këtë ligj nuk është i paraparë me Kushtetutë dhe nuk është i paraparë brenda formës së qeverisjes dhe ndarjes së pushtetit. Palët e kanë pranuar vendimin e Kushtetueses. Dy subjektet opozitare që e kanë adresuar këtë çështje në Kushtetuese, Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK) dhe Lëvizja Vetëvendosje (LV), kanë kërkuar dorëheqjen e qeverisë

Shtohen gjasat për mbajtjen e zgjedhjeve në vjeshtë

Përveç mbledhjes së nënshkrimeve të opozitës për rrëzimin e qeverisë, edhe vendimi i Gjykatës Kushtetuese, se delegacioni shtetëror është antikushtetues, ka shtuar gjasat që këtë vit të organizohen zgjedhje të parakohshme. Madje, sipas përfaqësuesve të partive opozitare, pas zhvillimeve të fundit në skenën politike zgjedhjet e parakohshme pritet të mbahen në vjeshtë



Veseli: Lufta kundër korrupsionit është e pakompromis

F. 7

RENOVA
PUTZ
Maqedoni
Xhepcisht-Tetovë
Gurëz-Ferizaj
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009
+389 44 487 755
Fax: +389 44 487 200
Mob: +377 44 501 289
E-mail: renova@mt.net.mk

PRINCESHA
GROUP SH.P.K.
NDËRTIM
PROJEKTIM
SHITJE
INFO: 049-111-101,
044-511-177
www.princesha-ks.com

Bunjamini
FABRIKA E LLAQEVE
MITROVICË
044/256-051
044/367-061
028/532-617
STYROKOL · BUNJAKOL · EUROFASADË

Kolegji BIZNESI
www.kolegijbiznesi.com
info@kolegijbiznesi.com
038 500 878 | 045 500 878
044 500 878 | 049 500 878

SIGMA
VIENNA INSURANCE GROUP
SIGMA INTERALBANIAN VIENNA INSURANCE GROUP SH.A
DEGA KOSOVË
Rruga "Pashko Vasa", p.n Prishtinë, Kosovë, p.n Prishtinë, Kosovë,
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302
E-mail: info@sigma-ks.net | www.sigma-ks.net

DINO
Konjuh Lipjan, Magj. Prishtinë Ferizaj-Kosovë
tel & fax +381 38 566 666

Meta cakton 13 tetorin datë të re të zgjedhjeve lokale, Rama kundërshton

Derisa presidenti i Shqipërisë Ilir Meta ka bërë të ditur se ka dekretuar 13 tetorin si ditë kur qytetarët e Shqipërisë do të votojnë për kryebashkiakët e tyre, Edi Rama ka reaguar menjëherë, duke e quajtur "çmenduri" vendimin e presidentit dhe ripërsëriti se data e vetme e zgjedhjeve në Shqipëri është 30 qershori



TIRANË, 27 QERSHOR - Presidenti i Shqipërisë Ilir Meta ka caktuar një datë të re të zgjedhjeve lokale në vend. Në një konferencë për media, presidenti bëri të ditur se ka dekretuar 13 tetorin si ditë kur qytetarët e Shqipërisë do të votojnë për kryebashkiakët e tyre.

Ai ka paraqitur dekretin e ri të nënshkruar për këtë datë dhe ka arsyetuar atë duke thënë se është dita më e shpejtë që mund të krijohet një ambient për organizim të zgjedhjeve gjithëpërfshirëse.

"13 tetori është dita më e shpejtë për të organizuar zgjedhje të përgjithshme vendore gjithëpërfshirëse. Jo vetëm për sa i takon vullnetit të atyre që dëshirojnë të marrin pjesë në zgjedhje, por njëkohësisht edhe që dëshirojnë që në bazë të të gjithave afateve ligjore dhe procedurale të jenë të përfshirë në një administrim gjithëpërfshirës të procesit të procesit zgjedhor", tha presidenti, ka njoftuar rfe.

Meta po ashtu bëri të ditur se vendimi i tij për mbajtje të zgjedhjeve më 13 tetor ka të bëjë edhe me garantimin e vazhdimësisë së Shqipërisë në procesin e saj integruar në Bashkimin Evropian.

"Një nga arsyt kryesore ka të

bëjë me garantimin e vazhdimësisë së integritetit evropian, të mos-shkëputjes së Shqipërisë nga Maqedonia e Veriut lidhur me momentin e çeljes së negociatave", tha Meta duke shtuar se vendi tashmë ka humbur mjaft kohë që nga vendimi i tij për anulim të zgjedhjeve, por theksoi se Shqipëria vazhdon të jetë në agjendën evropiane për të marrë një vendim pozitiv.

Kryeministri Edi Rama ka reaguar menjëherë në Twitter, duke e quajtur "çmenduri" vendimin e presidentit dhe ripërsëriti se data e vetme e zgjedhjeve në Shqipëri është 30 qershori.

Vendimi i së enjtes për datën e re të zgjedhjeve vjen pasi presidenti Meta zhvilloi një sërë takimesh me përfaqësues të partive opozitare si dhe disa ambasadorë.

Ndërkohë, kryeministri Rama refuzoi një ditë më parë ftesën e presidentit Meta për takim dhe dialog me arsyetimin se është i zënë me fushatën elektorale.

Shqipëria, tash e sa kohë, është përfshirë në një krizë politike.

Opozita, me muaj, proteston kundër Qeverisë së udhëhequr nga kryeministri Edi Rama dhe është zotuar se do t'i bojkotojë zgjedhjet lokale të 30 qershorit.

Edhe pse zgjedhjet janë anuluar nga presidenti Meta, një vendim i tillë nuk po përfilllet nga Partia Socialiste, lider i së cilës është Rama.

Ndërkohë, zëvendësndihmësekretari amerikan i Shtetit, Mathew Palmer, ka theksuar se ShBA-ja nje datën 30 qershor si datën e zgjedhjeve lokale.

"Ne presim që zgjedhjet të zhvillohen më 30 qershor, të jenë të qeta e të rregullta", ka

tha Palmer për "Zërin e Amerikës".

Ndërka, kongresisti amerikan Eliot Engel, kryetar i Komisionit të Jashtëm të Dhomës së Përfaqësuesve, u bëri thirrje të gjitha palëve "të qëndrojnë larg konfrontimit, të tregojnë përmbajtje maksimale dhe të ndalojnë të gjitha aktet e dhunës".

Në një deklaratë, Engeli shprehu shqetësim për gjendjen e tensionuar në Shqipëri, ku siç

tha ai, udhëheqësit politikë duket se kanë arritur një "rrugë pa krye".

"Kjo mosmarrëveshje, thotë ai, mund të zgjidhet vetëm me dialog dhe në bazë të sundimit të ligjit."

"Shqipëria, thuhet në deklaratë, është anëtare e NATO-s dhe meriton një të ardhme evropiane, por krizat e përsëritura rreth zgjedhjeve e minojnë ecjen e saj përpara".

Gjykata në Budapest hedh poshtë kërkesën për ekstradimin e Gruevskit

BUDAPEST, 27 QERSHOR - Ish-kryeministri maqedonas Nikolla Gruevski ka dalë të enjten para gjykatës në Budapest lidhur me kërkesën e autoriteteve në Shkup për ekstradimin e tij.

Por gjykatësja ka vendosur që ai të mos ekstradohet dhe të lihet i lirë. Sipas raportimit të medieve në Budapest, gjykata nuk mund të miratonte ekstradimin për një person të cilit tashmë i është dhënë azili në Hungari.

Ish-kryeministri Gruevski i arratisur nga vendi i tij, u pabrenda gjykatës në Budapest me një kapele bejsbolli në kokë, me syze dielli dhe një xhakë të hedhur

mbi duar, që sipas të gjitha gjasave ishin të lidhura me pranga.

"Sot është zbatuar procedurë standarde e institucioneve në Hungari, pasi Qeveria kriminale dhe zvatëse në Maqedoni parashitroi kërkesë për ekstradim. Gjykata e shqyrtoi kërkesën për ekstradim dhe vendosi që të mos e pranojë", deklaroi ish-kryeministri Nikolla Gruevski.

Nikolla Gruevski u arratis nga vendi para shtatë muajve. Tani për tani askush nuk e di se si është arratisur, kush i ka ndihmuar dhe kë e ka pasur logjistikë. Evetnja gjë që është vërtetuar është se përmes Shqipërisë me makinë diplo-

matike të Hungarisë, përmes Malit të Zi dhe Serbisë, ka mbërritur në Hungari. Kërkoj azil, e mori në mënyrë të shpejtë. Se si është arratisur Gruevski vetëm mund të supozohet, ndërsa kryeministri Zoran Zaev para do kohe deklaroi se ai është arratisur që të mos shkojë në burg i fshehur në bagazh. Dhe përderisa prokuroria është duke hetuar se si e ka braktisur vendin, Gruevski është aktiv në Budapest. Shpesh është në takime me ministrin e atjeshëm të Jashtëm i cili i konfirmoi takimet në të cilat Gruevski e ka informuar për situatën në Ballkanin Perëndimor.



Opozitarët besojnë në suksesin e mocionit për rrëzimin e qeverisë

Shtohen gjasat për mbajtjen e zgjedhjeve në vjeshtë

Përveç mbledhjes së nënshkrimeve të opozitës për rrëzimin e qeverisë, edhe vendimi i Gjykatës Kushtetuese, se delegacioni shtetëror është antikushtetuese, ka shtuar gjasat që këtë vit të organizohen zgjedhje të parakohshme. Madje, sipas përfaqësuesve të partive opozitare, pas zhvillimeve të fundit në skenën politike zgjedhjet e parakohshme pritet të mbahen në vjeshtë



EPOKA E RE Shqipe HETEMI

PRISHTINË, 27 QERSHOR - Përfaqësuesit e partive opozitare kanë shprehur optimizëm se në vjeshtë do të ketë zgjedhje të parakohshme. Sipas tyre, zgjedhjet e reja janë zgjidhja e vetme për ta tejkaluar gjendjen në vend. Anëtari i Kryesisë së Lidhjes Demokratike të Kosovës (LDK), Imri Ahmeti, ka thënë për gazetën "Epoka e re" se në shtator synohet rrëzimi i qeverisë dhe mbajtja e zgjedhjeve të reja. "Të gjitha rrethanat janë treguese të mjaftueshme se në shtator do të ketë rrëzim të qeverisë. Në këtë situatë në të cilën gjendet vendi ynë është e nevojshme të kemi një proces zgjedhor këtë vit sepse nuk ka alternativë tjetër. Po i shohim dallimet esenciale në mes të krerëve institucionalë në përfaqësimin e vendit në institucione të ndryshme ndërkombëtare. Mendoj se vendit tonë nuk i duhen dy apo tre zëra të tillë, por i duhet një zë më unifikues dhe një legjitimitet më i fortë i institucioneve të reja që do të dalin nga zgjedhjet", ka deklaruar Ahmeti.

Ai ka treguar se opozita nuk llogarit në votat e deputetëve serbë për rrëzimin e qeverisë, por në votat që mund të vijnë nga koalicioni qeverisës. "Ka indikacione të tilla dhe aktualisht opozita nuk llogarit në votat e deputetëve serbë, por llogarit në votat shtesë që mund të vijnë nga koalicioni qeverisës", është shprehur Ahmeti. Edhe deputeti i Lëvizjes

Vetëvendosje (LV), Rexhep Selimi, beson në suksesin e opozitës për rrëzimin e qeverisë. Ai ka thënë për gazetën "Epoka e re" se rrethanat për të pasur zgjedhje të parakohshme në Kosovë janë krijuar qysh moti. "Pika e përbashkët për LV-në dhe për LDK-në është që kjo qeveri duhet të dorëhiqet ose të rrëzohet. Me gjithë dallimet që i kemi si subjekte të ndara politike, rrëzimi i qeverisë është pika jonë e përbashkët. Rrethanat për të pasur zgjedhje të parakohshme në Kosovë janë krijuar qysh në ditën e parë të qeverisë Haradinaj, kur kjo qeveri prej atëherë e deri më sot nuk ia ka arritur ta manifestojë shumicën parlamentare në Kuvend. Prandaj, kur një qeveri nuk e ka shumicën parlamentare, kur në Kuvend tashmë ka ndryshuar raporti politik, kur në Kuvend nuk mund të votohen nga mazhoranca as ligjet me shumicë të thjeshtë, kur skandalet janë përditshmëri serike e qeverisë dhe, në anën tjetër, kur pakënaqësia e qytetarëve vjen duke u rritur përditë, atëherë vetëm zgjedhjet duhet të ndodhin para se të shkojë vendi në kolaps. Në këtë situatë Lëvizja Vetëvendosje është e angazhuar që në mundësinë e parë të shkojmë drejt zgjedhjeve të parakohshme qoftë me mocion mosbesimi, qoftë me dorëheqje të qeverisë. Mbështetur në këtë qëndrim, Lëvizja Vetëvendosje angazhohet që opozita t'i mbledhë votat e mjaftueshme për mocionin për rrëzimin e qeverisë", ka deklaruar Selimi,

duke shtuar se opozita nuk llogarit në votat e Listës Serbe për rrëzimin e qeverisë.

Edhe nënkryetari i Partisë Socialdemokrate (PSD), Visar Ymeri, ka thënë për gazetën "Epoka e re" se po rriten gjasat për suksesin e mocionit të mosbesimit. Ai ka treguar se PSD-ja ka qenë partia e parë që i ka dorëzuar nënshkrimet e deputetëve të vet për një mocion mosbesimi ndaj qeverisë. "Që prej atëherë ne kemi qenë në përkrahje për një mocion të tillë, gjithnjë të vetëdijshëm se në Kuvend atëbotë, si edhe sot, nuk i kemi 61 deputetët e nevojshëm për votimin e mocionit. Mendoj se po rriten gjasat për suksesin e një mocioni të tillë. Për ne është tejet e rëndësishme jo vetëm si arrijmë deri te mocioni, por çfarë ndodh pas tij (pas zgjedhjeve)? A do të ketë ndryshim pas zgjedhjeve? Apo vetëm përsëritje të së njëjtës mendësi e cilësi të politikëbërjes dhe vendimmarrjes. Ju kujtohet se VLAN-i rezultoi me kalimin e LDK-së në anën e PDK-së, për pushtetin vetëm si pushtet. Njëllor me VAN-in, kur AAK-ja doli në anën e PDK-së. Që të dy

këto qeveri jo vetëm e mbajtën PDK-në në pushtet, por edhe e vazhduan në mënyra dhe me ritëm të ndryshëm, qeverisjen neoliberalë, konservatore dhe të korruptuar", ka thënë Ymeri, duke shtuar se dy çështje janë pothuajse të domosdoshme që të ndryshojë pozitivisht gjendja aktuale në Kosovë. "E para është që PDK-ja të shkojë në opozitë, e dyta që qeveria e ardhshme e Republikës së Kosovës të ketë politika sociale dhe zhvillimore dhe kapacitete demokratike, si dhe të jetë e pakompromis në luftën kundër kriminit të organizuar dhe korrupsionit. Përndryshe, nuk do të kemi kurrfarë ndryshimi në raport me shtetin e kapur, procesin e domosdoshëm të vetingut në sektorin e sundimit të ligjit, në orientimin e kapaciteteve ekonomike në funksion të zhvillimit ekonomik dhe mirëqenies shoqërore si dhe në demokratizimin e vendit", ka thënë Ymeri.

Edhe kryetarja e Alternativës, Mimoza Kusari-Lila, ka bërë me dije se zgjedhjet e parakohshme janë e vetmja zgjidhje për vendin. Ajo beson

se mocioni i mosbesimit ndaj qeverisë do të jetë i suksesshëm dhe vendi do të shkojë shumë shpejt në zgjedhje të reja. "Mendoj se koha më e mirë për zgjedhje të parakohshme do të ishte vjeshta e hershme apo vera e vonë sepse, pas shpërbërjes së Kuvendit, nënkuptohet se 30 deri në 45 ditë duhet të shkojë vendi në zgjedhje. Nëse mocioni i mosbesimit të qeverisë kalon gjatë muajit të ardhshëm, i bie që në Kosovë të ketë zgjedhje në verën e vonë apo vjeshtën e hershme. Mendoj se zgjedhjet janë e vetmja zgjidhje aktualisht për daljen nga situata aktuale dhe kthimi në binarë të proceseve në Kosovë. Ka humbur komplet orientimi i vendit për çfarëdo procesi zhvillimor. Krejt çka bëhet sot është një ndarje e pushtetit në mes të partive në koalicionin qeverisës në formën më të vrazhdët të mundshme, derisa shumë pak diskutohet për tema të cilat janë me peshë për qytetarët dhe të cilat do të kenë një ndikim të drejtpërdrejtë në përmirësimin e jetës së qytetarëve të Kosovës", ka deklaruar Kusari-Lila për gazetën "Epoka e re".

Roli dhe misioni i prokurorit të shtetit, temë ligjërimit për kadetët e rinj të Policisë së Kosovës



PRISHTINË, 27 QERSHOR (ER) - Prokurorja e Prokurorisë Themelore në Prishtinë, Shenaj Berisha, ka ligjëruar për kadetët e rinj të Policisë së Kosovës në kuadër të trajnimit të organizuar nga Akademia për Siguri Publike e Kosovës në Vushtrri.

Qëllimi i këtij trajnimit ishte shpallja e temave të rëndësishme të lartë për shkollimin e kadetëve të rinj, duke iu ofruar atyre mbështetje për formimin e tyre,

sepse do të jenë në shërbim të sigurisë dhe mirëqenies së qytetarëve të Kosovës.

Rrjedhimisht, gjatë trajnimit kadetët u njohën me rolin e prokurorit të shtetit si institucion i pavarur për ndjekjen penale të personave të akuzuar, mandatin dhe strukturën e prokurorit të shtetit, si dhe kompetencat lëndore dhe territoriale, në këtë kontekst edhe të rolit të prokurorisë themelore, tema këto të cilat

zgojnë interesim në procesin e formimit të tyre profesional dhe do të ushtrojnë ndikim të veçantë në të ardhmen e tyre si kadetë të rinj të Policisë së Kosovës.

Qasja me shembuj praktikë dhe transmetimi i pamjeve vizuale në prezantimin e ligjërimit nga prokurorja Berisha janë cilësuar si kontribut konkret, mjaft efektiv, atraktiv dhe i dobishëm për kadetët e rinj të Policisë së Kosovës.

Gjykata Kushtetuese ka vendosur në favor të lëndës së parashtruar nga dy partitë opozitare, Lidhja Demokratike e

Kushtetuesja e shfuqizon ek

Ligji për Detyrat, Përgjegjësitë dhe Kompetencat e Delegacionit Shtetëror të Republikës së Kosovës në Procesin e Dialogut me Serbinë është shpallur jokushtetues nga ana e Gjykatës Kushtetuese të Kosovës. Kushtetuesja ka bërë me dije se delegacioni shtetëror i cili është themeluar me këtë ligj nuk është i paraparë me Kushtetutë dhe nuk është i paraparë brenda formës së qeverisjes dhe ndarjes së pushtetit. Palët e kanë pranuar vendimin e Kushtetueses. Dy subjektet opozitare që e kanë adresuar këtë çështje në Kushtetuese, Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK) dhe Lëvizja Vetëvendosje (LV), kanë kërkuar dorëheqjen e qeverisë



EPOKA E RE

Muhamet KOCI

PRISHTINË, 27 QERSHOR - Gjykata Kushtetuese e ka shpallur jokushtetues ekipin negociator për bisedime me Serbinë. Kjo gjykatë ka njoftuar të enjten se ka vendosur në favor të lëndës së parashtruar nga dy partitë opozitare, Lidhjes Demokratike të Kosovës (LDK) dhe Lëvizjes Vetëvendosje (LV), me të cilën kontestohet jokushtetues Ligji për delegacionin e Kosovës në bisedimet me Serbinë.

Kushtetuesja, në njoftimin për medie, ka bërë me dije se delegacioni shtetëror i cili është themeluar me këtë ligj, nuk është i paraparë me Kushtetutë dhe nuk është i paraparë brenda formës së qeverisjes. "Gjykata e vlerësoi kërkesën të pranueshme për shqyrtim dhe në shtjellimin e meritave të kërkesës gjeti se: Delegacioni shtetëror, i cili është themeluar me Ligjin e kontestuar, nuk është i paraparë me Kushtetutë dhe nuk është i paraparë brenda formës së qeverisjes dhe ndarjes së pushtetit. Si i tillë, delegacioni shtetëror nuk mund të përfshihet në ndërveprimin e ndarjes, kontrollit dhe balancimit të pushteteve, gjegjësisht strukturën e ndarjes së pushtetit sikurse është e përcaktuar me nenin 4 të Kushtetutës", është thënë në njoftimin e Gjykatës

Kushtetuese, duke shtuar se edhe bartja e kompetencave është antikushtetuese. "Më tej, gjykata konstatoi se bartja e kompetencave të institucioneve kushtetuese të 'mekanizmi i posaçëm' i krijuar me ligjin e kontestuar është ndërhyrje në ushtrimin e kompetencave të institucioneve të përcaktuara me Kushtetutë dhe nuk është në pajtim me vlerat demokratike dhe të sundimit të ligjit, të përcaktuara me nenin 7 të Kushtetutës, sepse i mvësh delegacionit shtetëror funksione të cilat nuk përkojnë me dispozitat kushtetuese. Gjykata, po ashtu, konstatoi se me normat kushtetuese në mënyrë shprehimore është paraparë obligimi përkritazi me ushtrimin e kompetencave kushtetuese në sferën e politikës së jashtme për institucionet kompetente dhe se kompetenca për të dialoguar me një shtet të tretë nuk mund të bartet te delegacioni shtetëror si 'mekanizëm i posaçëm' përmes një akti më të ulët juridik siç është ligji i kontestuar", ka vlerësuar kushtetuesja.

Më tutje, Gjykata Kushtetuese ka konstatuar se Kuvendi i Republikës së Kosovës është i obliguar ta mbikëqyrë politikën e jashtme në kuadër të kompetencave kushtetuese të parapara sipas paragrafit 12 të nenit 65 të Kushtetutës. "Gjykata, po ashtu, theksoi se paragrafi 1, i nenit 93

të Kushtetutës, i përcakton kompetencat e qeverisë në 'propozimin dhe zbatimin e politikës së brendshme dhe të jashtme të vendit', përdorësi paragrafët 1 dhe 9 të nenit 94 përcaktojnë se kryeministri, si i pari i qeverisë, 'përfaqëson dhe udhëheq qeverinë', si dhe 'këshillohet me presidentin për zbatimin e politikës së jashtme të vendit'. Rrjedhimisht, Gjykata konkludoi se përfaqësimi në sferën e politikës së jashtme është detyrë e institucioneve kushtetuese të Republikës së

Kosovës. Kjo kompetencë është e përcaktuar me Kushtetutë dhe nënkupton, para së gjithash, që çdo negociim apo veprim tjetër që ka të bëjë me lidhjen e marrëveshjeve ndërkombëtare në emër të Republikës së Kosovës duhet të jetë brenda detyrimeve kushtetuese që kanë institucionet e Republikës së Kosovës", ka vlerësuar Gjykata Kushtetuese, duke shtuar se kompetenca për arritjen e marrëveshjeve ndërkombëtare nuk mund të bartet ose transferohet nga insti-

tucionet kushtetuese në një "mekanizëm të posaçëm", siç parashihet me ligjin e kontestuar. Në fund, Gjykata Kushtetuese njëzëri ka vendosur që nenet 1 (paragrafi 1), 2, 4, 10 (paragrafi 4, nënparagrafët 1 dhe 2) dhe neni 11 (paragrafi 3) të Ligjit nr. 06/L-145 për Detyrat, Përgjegjësitë dhe Kompetencat e Delegacionit Shtetëror të Republikës së Kosovës në Procesin e Dialogut me Serbinë, nuk janë në pajtueshmëri me paragrafët 1, 2, 3 dhe 4 të nenit 4 [Forma e

Thaçi: Duhet të jemi të bashkuar në procesin e dialogut


Presidenti i Kosovës, Hashim Thaçi, ka reaguar pas vendimit të Gjykatës Kushtetuese, e cila e ka shpallur jokushtetues Ligjin për Detyrat, Përgjegjësitë dhe Kompetencat e Delegacionit Shtetëror të Republikës së Kosovës në Procesin e Dialogut me Serbinë. Ai ka thënë se Republika e Kosovës ka qenë, është dhe do të jetë gjithmonë e përkushtuar për forcimin e paqes dhe stabilitetit përmes dialogut dhe rrugës evropiane, me mbështetjen e ShBA-së dhe gjithë partnerëve tanë.

Thaçi ka theksuar se Kushtetuta e Republikës së Kosovës është udhërrëfyesi ynë në çdo hap drejt forcimit të shtetësisë sonë dhe

drejt integritetit euroatlantik të shtetit tonë. "Por, askush i vetëm nuk mund ta marrë barrën e zgjidhjes së një konflikti shekullor me Serbinë, prandaj gjithmonë kam apeluar për unitet politik në këtë proces shumë të rëndësishëm për vendin dhe qytetarët tanë. Kosova, shtet i pavarur dhe i integruar në BE, NATO dhe OKB, në paqe dhe me fqinjësi të mirë, është obligim ynë për gjeneratat e reja të cilat nuk duhet të rriten me urrejtje ndëretnike dhe me ngarkesa çfarë kemi pasur ne. E kemi fituar luftën dhe duhet ta fitojmë edhe paqen për qytetarët e të gjitha komuniteteve që jetojnë në shoqërinë tonë shumëtnike",

ka thënë Thaçi.

Ai ka shtuar se si president i vendit vlerëson shumë vullnetin politik dhe përgjegjshmërinë individuale të kryesuesve të ekipit negociator, të cilët, kur Kosova ka vluar nga debatet shterpe politike, kanë qenë në gjendje të dalin përtej tyre dhe të marrin përgjegjësi shtetërore. "Në përputhje me Kushtetutën dhe vullnetin politik, udhëheqësit e institucioneve, liderët politikë të të gjitha subjekteve, duhet të jenë të bashkuar në procesin e dialogut për arritjen e marrëveshjes paqësore, e cila hap perspektivën e integritetit të Kosovës dhe i jep fund izolimit dhe stagnimit", ka deklaruar Thaçi.



Kosovës (LDK) dhe Lëvizja Vetëvendosje (LV)

ipin negociator të dialogut



Opozita kërkon dorëheqjen e qeverisë

Dy partitë opozitare që e kanë dërguar në Kushtetuese këtë ligj, Lidhja Demokratike e Kosovës dhe Lëvizja Vetëvendosje, kanë kërkuar dorëheqjen e qeverisë. Në një konferencë për media, shefi i grupit parlamentar i LDK-së, Avdullah Hoti, ka deklaruar se dialogu duhet të udhëhiqet nga institucionet kushtetuese. "Shkelje është bërë me draftrezolutën kur dialogu ka kaluar te presidenti. Vlerësojmë se sot menjëherë ekipi duhet të japë dorëheqje, kurse vendi duhet të shkojë në zgjedhje", ka thënë Hoti. Sipas tij, një qeveri e cila shkel Kushtetutën nuk duhet të vazhdojë ta qeverisë vendin.

"Çdo ditë e më shumë që rri në zyrë kjo qeveri bën shkelje kushtetuese. Dialogun duhet ta udhëheqë një qeveri legjitime e dalë nga zgjedhje të lira dhe demokratike. Kemi një qeveri e cila e ka shkelur Kushtetutën", ka deklaruar Hoti.

Edhe deputetja e Lëvizjes Vetëvendosje, Albulena Haxhiu, ka komentuar vendimin e Gjykatës Kushtetuese të Kosovës. Në një konferencë për media ajo ka thënë se presidenti Hashim Thaçi më nuk mund ta udhëheqë Kosovën në bisedimet me Serbinë. "Siç kemi thënë në kohën kur e kemi kontestuar Ligjin për dialogun, projektligji për dialogun ka kri-

juar një delegacion jokushtetues të cilit ia mveshën. Gjykata Kushtetuese sot konstatoi që Ligji për Dialogun është antikushtetues në tërësinë e tij", është shprehur ajo. Sipas Haxhiut, zgjidhja e vetme është shkuarja në zgjedhje të jashtëzakonshme. "Ne e kemi kundërshtuar presidentin Thaçi, mënyrën se si ka shkuar ky dialog me Serbinë. Në këto rrethana ku kemi një president që në mënyrë jo kushtetuese ka udhëhequr dialogun, dhe kryeministrin i cili refuzoi t'i marrë kompetencat e tij, zgjidhja e vetme është të shkohet në zgjedhje të jashtëzakonshme", ka deklaruar Haxhiu.

anëtarët e ekipit negociator nga radhët e PSD-së do të largohen. "Partia Socialdemokrate e pranon këtë vendim dhe do të veprojë sipas tij. Rrjedhimisht nga sot anëtarët e delegacionit shtetëror nga radhët e PSD-së pushojnë të shërbejnë në këtë organ. Ne kemi hyrë në delegacion me kushtin që delegacioni të ketë kompetenca. Meqenëse ato nuk janë më, atëherë qëndrimi ynë në delegacion është pa kurrfarë rëndësie ligjore. Partia Socialdemokrate vitin e kaluar ka marrë iniciativën për ta kthyer procesin e vendimmarrjes në lidhje me dialogun me Serbinë, në Kuvendin e Republikës së Kosovës", ka shkruar Ahmeti në profilin e vet në "Facebook". Ai ka vlerësuar se kërkesa e PSD-së ishte që të hiqet monopoli i presidentit Hashim Thaçi mbi dialogun dhe vendimmarrja të shpërndahet në institucionin më

të lartë ligjvënës në vend. "Fatkeqësisht, tentimin tonë për t'ia dhënë kompetencat dhe fuqinë vendimmarrëse Kuvendit e sfiduan dy partitë e tjera opozitare, LDK-ja dhe LV-ja. Që nesër ne do t'i dorëzojmë dorëheqjet nga delegacioni në Kuvend. Ne edhe më tutje besojmë se dialogu me Serbinë është procesi më i rëndësishëm politik sot në Kosovë dhe për të nevojitet konsensus dhe vendimmarrje në Kuvend. Përndryshe, pas sfidimit të LDK-së dhe të LV-së, ky proces tani kthehet në duart e presidentit dhe kryeministrit", është shprehur Ahmeti.

Edhe zëvendëskryetari i Partisë Demokratike të Kosovës (PDK), i cili edhe ka qenë anëtar i ekipit negociator, Enver Hoxhaj, ka reaguar pas vendimit të Gjykatës Kushtetuese e cila e shpalli antikushtetues këtë ekip negociator. Ai përmes një postimi në

llogarinë e vet në "Facebook" ka shkruar se nga fillimi PDK-ja ka besuar se Kosova ka institucionet legjitime për ta udhëhequr procesin e dialogut duke respektuar Kushtetutën e vendit. "Ne do ta respektojmë vendimin e Gjykatës Kushtetuese mbi vlerësimin e kushtetutshmërisë së Ligjit për Detyrat, Përgjegjësitë dhe Kompetencat e Delegacionit Shtetëror të Republikës së Kosovës në Procesin e Dialogut me Serbinë. Nga fillimi, PDK-ja ka besuar se Kosova ka institucionet legjitime për ta udhëhequr procesin e dialogut duke respektuar Kushtetutën e vendit. Ne vazhdojmë të besojmë se, megjithatë, konsensusi politik është i nevojshëm për ta arritur marrëveshjen finale me Serbinë që do të përfundonte me njohje të ndërsjellë dhe ulëse në OKB", ka shkruar Hoxhaj.

Qeverisjes dhe Ndarja e Pushtetit], paragrafin 1 të nenit 7 [Vlerat], paragrafin 12 të nenit 65 [Kompetencat e Kuvendit], paragrafin 1, të nenit 93 [Kompetencat e Qeverisë], dhe paragrafët 1 dhe 9 të nenit 94 [Kompetencat e Kryeministrit] të Kushtetutës, dhe se rrjedhimisht ligji i kontestuar, në tërësinë e tij, është i papajtueshëm me Kushtetutën.

Palët pranojnë vendimin, fillojnë dorëheqjet e anëtarëve të ekipit negociator


Menjëherë pas vendimit të Gjykatës Kushtetuese, bashkëkryesuesi i ekipit negociator, Shpend Ahmeti, ka pranuar vendimin e Gjykatës Kushtetuese, duke theksuar se

Veseli: Lufta kundër korrupsionit është e pakompromis

PRISHTINË, 27 QERSHOR (ER) - Kryetari i Kuvendit të Republikës së Kosovës, Kadri Veseli, ka pritur të enjten në takim Auditorin e Përgjithshëm, Besnik Osmani, me të cilin ka diskutuar për të gjeturat që kanë dalë nga raportet e Zyrës së Auditorit të Përgjithshëm. Në takim u vlerësua se Kuvendi i Republikës së Kosovës vazhdon të jetë institucioni më serioz sa i përket menaxhimit të parasë publike.

Kreu i Kuvendit, Kadri Veseli, tha se transparenca dhe llogaridhënia nuk janë vetëm parime kushtetuese sa i përket shpenzimit të parasë publike, por janë detyrime ligjore që çdo institucion duhet t'i ndjekë në përpikëri. "Shteti i Kosovës humb miliona euro si rezultat i korrupsionit,

keqmenaxhimit dhe moszbatimit të drejtë të ligjit për menaxhimin e financave publike. Këto para do të mund të përdoren për mirëqenien e qytetarëve tanë, duke investuar në arsim, shëndetësi dhe hapjen e vendeve të reja të punës. Zyra e Auditorit dhe Auditori i Përgjithshëm do ta kenë mbështetjen time për ruajtjen e parasë publike dhe mirëqenies së qytetarëve", ka theksuar kryeparlamentari Veseli. Ai ftoi prokurorinë e shtetit që t'i shikojë me vëmendje të gjeturat e raporteve të Zyrës së Auditorit për të gjitha institucionet dhe t'i ndërmarë veprimet e nevojshme ndaj keqpërdoruesve të parasë publike. "Lufta kundër korrupsionit është e pakompromis dhe ne do t'i shkojmë deri në fund", ka thënë Veseli.



Kadetët e diplomuar të FSK-së japin betimin për shërbim ndaj shtetit

Kryeministri Ramush Haradinaj, duke i uruar kadetët për diplomimin, emërimin dhe gradimin si dhe për shërbimin me vetëmohim ndaj vendit, ka thënë se këta kadetë janë gjenerata e parë që diplomojnë pas mandatimit të FSK-së si Forcë Mbrojtëse e Kosovës



EPOKA
ERE Qendresa RAMA

FERIZAJ, 27 QERSHOR - Në Kazermën "Skënderbeu" të Komandës së Doktrinës dhe Stërvitjes (KDS) në Ferizaj është mbajtur të enjten ceremonia e diplomimit të tetë kadetëve të Forcës së Sigurisë së Kosovës dhe dy kadetëve të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë, të shkolluar në Qendrën për Studime Universitare të FSK-së, të cilët janë graduar me gradën e nëntogerit si dhe kanë marrë emërimet në detyrë për shërbim si oficerë të rinj në FSK, përkatësisht në ushtrinë shqiptare.

Në këtë ceremoni morën pjesë kryeministri Ramush Haradinaj, ministri i Mbrojtjes Rustem Berisha, komandanti i FSK-së, gjenerallejtënant Rrahman Rama, ministri i Punëve të Brendshme Ekrem Mustafa, drejtori i Ekipit Këshillues dhe Ndërlidhës i NATO-s (NALT), gjeneral Uwe Becker, komandanti i QSU-së, major Vegim Krelani si dhe deputetë, gjeneralë dhe oficerë të FSK-së, KFOR-it, atashë ushtarakë dhe të mbrojtjes nga

shtete të ndryshme, familjarë të kadetëve dhe mysafirë të tjerë. Me këtë rast, kryeministri Haradinaj, duke i uruar kadetët për diplomimin, emërimin dhe gradimin si dhe për shërbimin me vetëmohim ndaj vendit, ka theksuar se këta kadetë janë gjenerata e parë që diplomojnë pas votimit në parlament, edhe pas mandatimit të FSK-së si Forcë Mbrojtëse e Kosovës, duke u bërë kështu vetë historia. "Ju uroj për gradimin dhe ju falënderoj për shërbimin e deritashëm. Ju ftoj që të shërbeni me nder në ushtrinë e Kosovës, për popullin e Kosovës, për paqen dhe për rreshtin e ushtrive të paqes të cilit ne i takojmë dhe do t'i takojmë, pra së shpejti në NATO, së cilës i prin ShBA-ja", ka thënë kryeministri Haradinaj. Ministri i Mbrojtjes, Rustem Berisha, ka thënë se ka nderin që sot të marrë pjesë në këtë datë të rëndësishme për karrierën dhe jetën e kadetëve, por edhe FSK-në dhe shtetin e Kosovës. "Sot duhet të jeni krenarë për arritjet tuaja dhe të zotoheni që ta nderoni uniformën e FSK-së, ta nderoni atdheun

dhe të mbroini paqen, liritë dhe shtetin e ndërtuar me shumë sakrificë. Ju jeni pjesë e një force profesionale, të besueshme, shumetnike që jemi duke e ndërtuar bashkë me aleatët tanë. Synimi ynë strategjik është anëtarësimi në NATO dhe unë jam i bindur se pa marrë parasysh sfidat gjeopolitike të çastit, me djemtë dhe vajzat si ju e ardhmja euroatlantike e Republikës së Kosovës është e sigurt", ka thënë Berisha.

Edhe komandanti i FSK-së, gjenerallejtënant Rrahman Rama, ka thënë se të gjithë sot janë bashkë këtu për t'i përgëzuar kuadrot e reja që po i bashkohen FSK-së. "Nuk ka vlerë më të madhe se kur ke oficerë të devotshëm, profesionalë dhe me vlera të larta njerëzore në radhët e organizatës. Ju kadetë që po diplomoni sot, ju siguroj se

keni bërë gjënë më fisnike që mund ta bënit, të përgatiteni për katër vjet rresht. Jeni përgatitur për t'i mbrojtur qytetarët dhe për të kontribuar për një botë më të mirë për fëmijët tanë dhe të ardhmen e këtij vendi. Oficerët e rinj që kanë diplomuar në Qendrën për Studime Universitare po na bëjnë krenarë çdoherë me shkollime, trajnime dhe gara të ndryshme jashtë vendit", është shprehur Rama.

Në këtë ceremoni u ndanë diploma për dhjetë kadetët e diplomuar, ndërsa me medalje u nderua kadet Dritëro Bajrami për rezultate të larta në përvetësimin e programit mësimor përgjatë katër vjetëve të studimeve si dhe kapter Naim Smakolli, instruktor në Qendrën për Studime Universitare, u dekorua me "Medalje për shërbim

vetëmohues" për arritje të larta në planifikimin dhe zbatimin e planprogramit mësimor në QSU gjatë vitit akademik 2018/2019.

Kadetët e diplomuar në Qendrën për Studime Universitare dhe në R.I.T Kosova (A.U.K) tani nëntogerë të FSK-së: Ardit Deliu, Ardit Gashi, Dritëro Bajrami, Ilirianë Bunjaku, Jeta Berisha, Samet Kadrija, Valdrin Ismajli dhe Ylli Abazi, të cilët janë emëruar në detyra si komandues të togës në batalionet e Brigadës për Reagim të Shpejtë të FSK-së, dhanë betimin për shërbim.

Ndërsa kadetët e sapodiplomuar në QSU dhe tani nëntogerë nga Republika e Shqipërisë, Denis Bitri dhe Endrit Hate, do të sistemohen në Forcat e Armatosura të Republikës së Shqipërisë.

Ndahen certifikatat për të rinjtë pjesëmarrës të kampit veror 'Change-Makers'

PRISHTINË, 27 QERSHOR (ER) - Ministri i Kulturës, Rinisë dhe Sportit, Kujtim Gashi, mori pjesë në ceremoninë e ndarjes së certifikatave për pjesëmarrësit e kampit veror "Change-Makers" në parkun "Gërmia" në Prishtinë.

Kampi "Change-Makers" u përkrah financiarisht nga Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit dhe Programi "Përkrahje adoleshentëve pas mësimit të rregullt" (ASSET), i cili financohet nga USAID, ndërsa zbatohet nga Qendra për Arsim e Kosovës (KEC) në partneritet me FHI 360 dhe Crimson Capital Corp.

Gjatë kësaj ceremonie ministri Gashi ka theksuar se projekte dhe organizime të kësaj rinore janë edhe objektivi i ministrisë dhe atij si ministër që të rinjtë të njihen sa më shumë me njëri-tjetrin. "Sot kemi një ditë të rëndësishme për të gjithë të rinjtë e Kosovës, e veçanërisht për të rinjtë të cilët për herë të parë certifikohen si pjesëmarrës



në kampin veror, i cili ofron mundësinë që të rinjtë e Kosovës të marrin pjesë në kampe inovative verore falas", ka thënë ministri Gashi.

Në partneritet me Qendrën e Kosovës për Arsim (KEC) dhe

USAID-in, MKRS-ja mundësoi që 40 të rinj të ndërtojnë projekte kreative gjatë kampit dhe të përjetojnë aventura në natyrë. "Jam jashtëzakonisht i gëzuar që gjatë kësaj jave pjesëmarrësit kanë mësuar për lidërsip, kanë

zhvilluar shkathtësi të reja dhe kanë ndryshuar komunitetin e tyre përmes punës vullnetare. Shkollat 'Skënderbeu' dhe 'Dëshmorët e Kombit' në Kamenicë janë pajisur me dollapë dhe ulëse për kënd të

leximit dhe klasë, të ndërtuara nga vetë kampistët", ka deklaruar Gashi.

Ministri ka theksuar se mbetet i përkushtuar që do të jetë sa më afër të rinjve dhe përpiqet maksimalisht që t'u krijojë atyre lehtësira që t'i zhvillojnë aktivitetet dhe të kenë mundësi t'i realizojnë idetë e tyre inovative. "Unë zotohem që projektet e tilla si ministër do t'i mbështes në vazhdimësi sepse tashmë kemi krijuar edhe fondin rinor i cili në kuadër të objektivave parasheh edhe organizimin e kampeve në tërë Kosovën", u shpreh ministri Gashi, duke potencuar se ky nuk ka qenë kampi i parë, por se janë mbajtur edhe disa kampe të tjera.

Si shenjë mirënjohjeje dhe respekti për punën e bërë nga kampistët, ministri Gashi së bashku me Brian Martalus, drejtorin e Zyrës për Zhvillim Ekonomik në USAID, iu ndanë certifikatat kampistëve në ceremoninë përmblylëse të kampit.

Presidenti shpall listën e organizatave terroriste për vitin 2019

**EPOKA
ERE**

Qendresa RAMA

PRISHTINË, 27 QERSHOR - Presidenti i Republikës së Kosovës, Hashim Thaçi, duke marrë parasysh përkushtimin e Republikës së Kosovës që të kontribuojë në stabilitetin dhe sigurinë e rajonit dhe Evropës si dhe gatishmërinë që të jetë anëtare e denjë e familjes së shteteve paqedashëse në botë, të enjten ka nxjerrë dekret që obligon institucionet e sigurisë ta krijojnë listën vendore të personave, grupeve dhe organizatave të përfshira në akte terroriste, të cilat do t'iu nënshtrihen masave kufizuese në territorin e Republikës së Kosovës. Deri në krijimin e listës vendore, sipas dekretit të presidentit Thaçi, institucionet e sigurisë në Republikën e Kosovës do ta zbatojnë listën e Bashkimit Evropian të personave, grupeve dhe organizatave të përfshira në

akte terroriste, e cila është rifreskuar më 8 janar 2019. Institucionet e sigurisë në Republikën e Kosovës obligohen që t'i ndërmarrin masat kufizuese përkatëse në pajtim me praktikën ndërkombëtare ndaj të gjithë personave, grupeve dhe organizatave të përfshira në listën e Bashkimit Evropian. Republika e Kosovës ka dëshmuar në vazhdimësi përkrahje të pakompromis në luftën kundër ekstremizmit, radikalizmit dhe terrorizmit, duke dhënë shembull të mirë për tërë rajonin. Si pjesë aktive e aleancës globale kundër terrorizmit dhe ekstremizmit të dhunshëm, Republika e Kosovës do ta vazhdojë bashkëpunimin e ngushtë me Shtetet e Bashkuara të Amerikës, Bashkimin Evropian dhe partnerët e tjerë për eliminimin e çfarëdo rreziku që i kanoset Kosovës dhe partnerëve të saj.



Sistemet e avancuara të QKMK-së mundësojnë mbikëqyrje më të mirë kufitare

**EPOKA
ERE**

Faton DËRMAKU

PRISHTINË, 27 QERSHOR - Ministria e Punëve të Brendshme (MPB), Qendra Kombëtare për Menaxhim Kufitar dhe Programi për Kontrollin e Eksportit dhe Sigurinë e Kufijve (EXBS) të Ambasadës Amerikane, të enjten kanë bërë demonstrim të drejtpërdrejtë të sistemeve të QKMK-së duke përfshirë aftësinë e pranimi të thirrjeve të telefonatave përmes VOIP, Sistemin për Menaxhimin e Rasteve (CMS) dhe veglën për Analizë Inteligjente të Biznesit (BI). Ministri i Punëve të Brendshme, Ekrem Mustafa, ka thënë se Republika e Kosovës është shembull për shtetet e Ballkanit Perëndimor me një qendër të tillë. "Ky sistem i avancuar ofron informacione të shpejta që të kemi një mbikëqyrje më të mirë kufitare", ka deklaruar Mustafa. Koordinatori Nacional për Menaxhimin e Integruar të Kufirit, njëherësh zëvendësmin-



istër i Punëve të Brendshme, Isa Xhemajlaj, ka deklaruar se aplikacioni i ri do t'u mundësojë të gjithë qytetarëve të Kosovës dhe ata që kalojnë nëpër kufijtë e Republikës së Kosovës që të raportojnë për çdo dukuri që ndodh në kufi dhe, po ashtu, zyrtarëve të zbatimit të ligjit që t'i shfrytëzojnë aplikacionet për raportim dhe shkëmbim të

informacionit në kohë reale si në kufi dhe në brendi të vendit. Në këtë aktivitet morën pjesë edhe dy përfaqësues ndërkombëtarë, George R. Clarke nga Programi për Kontrollin e Eksportit dhe Sigurinë e Kufijve (EXBS) të Ambasadës Amerikane si dhe Alan Willson, këshilltar i lartë për çështje të MIK-ut në misionin EULEX të cilët potencuan rolin

dhe rëndësinë që e ka kjo qendër për ngritjen e bashkëpunimit dhe bashkërendimit ndërmjet autoriteteve të zbatimit të ligjit dhe ofrimit të shërbimeve për qytetarët. Sistemitet të cilat janë lansuar në QKMK janë sisteme të pranimi të thirrjeve nga numrat e besueshmërisë (HOT LINE), ku pastaj këto thirrje regjistrohen

në Sistemin për Regjistrimin e Rasteve duke iu referuar raportimeve nga qytetarët për fenomene negative si: korrupsion, trafikim me mallra, produkte ushqimore të dyshuara, sjellje jo e mirë e zyrtarëve shtetëror etj. Po ashtu, kjo qendër ka përfunduar edhe sistemin për Inteligjencë Biznesore (BI), ku ky sistem është ndërlidhur me 16 baza të të dhënave nacionale si ato nga të gjitha autoritetet për zbatimin e ligjit dhe sigurisë, ku me këtë mund të krijojnë raporte të ndryshme si: statistika, produkte analitike, profile, shenjëstrim dhe analiza inteligjente.

Përfundimi i këtij projekti siguron burimet, ekspertizën dhe informacionin e kërkuar për maksimizimin e aftësisë së Republikës së Kosovës për t'i mbështetur operacionet kufitare dhe të brendshme të zbatimit të ligjit dhe për të zbuluar, parandaluar, hetuar dhe reaguar ndaj veprimtarisë kriminale dhe terroriste.

Komuna e Drenasit bëhet me nënstacion elektrik

DRENAS, 27 QERSHOR (ER) - Komuna e Drenasit është pajisur të enjten me nënstacionin elektrik i cili do të jetë në shërbim për të gjitha familjet, ekonomitë familjare dhe bizneset e kësaj komune. Kryetari i Drenasit, Ramiz Lladrovci, ka thënë se kjo e arritur është shumë e mirëseardhur

ngaqë rryma nuk do të jetë më problem në komunën që udhëheq. "Falënderoj donatorët të cilët mirëkuptuan nevojën tonë për furnizim të qëndrueshëm me rrymë, ekzekutuesit e punimeve që nënstacioni elektrik të përurohet sipas planit, si dhe të gjithë bashkëpunëtorët që Drenasi të ketë nënstacion më modern në

Kosovë", ka thënë Lladrovci. Ai ka shtuar se nënstacioni elektrik është investim prej 6.8 milionë eurosh, investim nga KOST-i dhe BERZh-i. "Për 50 vjetët e ardhshëm e kemi të garantuar furnizimin si dhe do t'i shërbejë edhe Stadiumit Kombëtar dhe Parkut të Biznesit", ka theksuar kryetari Lladrovci.



Arrihet marrëveshja për furnizim të rregullt me energji elektrike për banesën kolektive në Stantërg

MITROVICË, 27 QERSHOR (ER) - Kryetari i Komunës së Mitrovicës, Agim Bahtiri, të enjten ka pritur në një takim kryeshefin ekzekutiv të KEDS-it, Alper Erbas, dhe këshilltarin e tij ekzekutiv, Avni Alidemaj, të cilët i ka njoftuar me problemet e ndryshme që qytetarët e komunës po kanë sa i përket furnizimit me rrymë elektrike dhe problemet me të cilat ata po ballafaqohen.

Në veçanti ai i njoftoi me problemet që kanë banorët e banesës kolektive në fshatin Stan Tërg lidhur me mungesën e furnizimit me energji elektrike si dhe banorët e fshatit Suhadoll,

ku janë raportuar dëme në shtyllat elektrike të cilat po rrezikojnë jetën e banorëve të atyshëm, të cilët edhe po përballen me reduktime të rrymës, pikërisht si pasojë e dëmtimit të këtyre shtyllave. "Ju kisha lutur që sa më parë ekipet tuaja profesionale të dalin në vend të ngjarjes, ta vlerësojnë gjendjen reale dhe të ndërmarrin masa për sanimin e dëmeve, përkatësisht për rregullimin e shtyllave, në mënyrë që banorët të kenë furnizim të rregullt me energji elektrike", ka thënë Bahtiri.

Ndërsa kryeshefi ekzekutiv nga KEDS-i, Alper Erbas, fillimisht ka falënderuar kryetarin Bahtiri



për bashkëpunimin e suksesshëm të deritashëm, falë të të cilit është arritur të realizohen shumë projekte të përbashkëta në të mirë të qytetarëve. Ai ka premtuar se menjëherë do t'i

dërgojë në terren ekipet përkatëse për t'i marrë masat e nevojshme për evitimin e avarive dhe për përmirësimin e furnizimit të rregullt me energji elektrike të këtyre fshatrave. Po

ashtu, kryetari Bahtiri ka kërkuar nga zyrtarët e KEDS-it që të angazhohen për përmirësimin e gjendjes edhe në fshatrat Vllahi, Rashan dhe Bare, pasi edhe ato kanë probleme me shtylla elektrike për shkak të vjetërsisë së tyre.

Në fund kryetari Bahtiri dhe drejtori i KEDS-it, duke marrë parasysh neglizhencën e treguar nga organet kompetente, u pajtuan që përmes një marrëveshje të përbashkët Komuna e Mitrovicës do ta marrë përsipër furnizimin me rrymë cilësore për një periudhë pesëvjeçare në banesën kolektive në fshatin Stan Tërg.

Themelohet Qendra e Certifikimit 'Dante Alighieri'

PRISHTINË, 27 QERSHOR (ER) - Në Kosovë për herë të parë është themeluar Qendra për Certifikim "Dante Alighieri", e cila do t'i certifikojë të gjithë ata që njohin gjuhën italiane me certifikatën "Plida" që njihet në Itali dhe gjithë botën.

Çdo vit mijëra njerëz në mbarë botën vërtetojnë njohuritë e tyre të italishtes me testet "Plida" dhe marrin një certifikatë të njohur nga shteti italian dhe që është vlefshme në mbarë botën.

"Plida" organizon provimet katër herë në vit dhe komisioni përbëhet nga: Giovanni Polliani, Arjeta Berisha, dhe Chiara Laura

Bonetti.

Studentët që kalojnë testet marrin certifikatën "Plida" të nivelit përkatës, ndërsa për t'u regjistruar për provimin e testit "Plida" nuk ka kufizime të moshës. Secili kandidat mund ta zgjedhë nivelin përkatës dhe nuk është e nevojshme që të ketë kaluar nivele më të ulëta. Po ashtu, secili kandidat zgjedhë nivelin që ai ose ajo e konsideron më të afërt me zotërimin e gjuhës italiane dhe mund të regjistrohet në disa nivele brenda të njëjtit sesion. Kalendarin për provimet e organizuara i vlefshëm në mbarë botën gjendet në www.plida.it.



Për çfarë shërben certifikimi "Plida": Për leje qëndrimi (nga niveli A2) (dekreti i presidentit 179, i datës 14 shtator 2011); për leje qëndrimi të gjatë (dekreti ministror, 4 qershor 2010). Regjistrimi bëhet në universitetin italian pa iu nënshtruar provimit të gjuhës italiane (niveli C1) (info: <http://www.studiare-in-italia.it/studentistranieri/>); të përjashtohen nga provimi italian për licencën dygjuhësore në Trentino Alto-Adige (dekreti presidencial 86, i 14 majit 2010); paraqitja në mënyrë transparente të nivelit tuaj të njohurisë italiane, në CV.

Bajram Kosumi rizgjedhet rektor i Universitetit 'Kadri Zeka'



GJILAN, 27 QERSHOR (ER) - Prof. asoc. dr. Bajram Kosumi është rizgjedhur rektor i Universitetit "Kadri Zeka" në Gjilan edhe për mandatin e ardhshëm katërvjeçar. Këshilli Drejtues, prej shtatë anëtarësh, ka votuar në mënyrë unanime për rektorin Kosumi. Kryesuesi i Këshillit Drejtues, kryesues dr. sc. Emrush Thaçi, ka vlerësuar se procesi për zgjedhjen e rektorit të UKZ-së ka shkuar mirë dhe pa asnjë

problem. "I gjithë procesi ka rrjedhur mirë dhe konform rregulloreve pa asnjë problem", ka thënë ai.

Ndërsa rektorin e porsazgjedhur prof. asoc. dr. Bajram Kosumi ka falënderuar anëtarët e KD-së për besimin e dhënë për ta udhëhequr Universitetin "Kadri Zeka" në mandatin e ardhshëm. "Besimi që më kanë dhënë është një përgjegjësi shtesë që të gjithë së bashku të punojmë për

zhvillimin e universitetit tonë", ka thënë rektori Kosumi.

Me zgjedhjen e rektorit është përmbyllur gjithë procesi zgjedhor në UKZ.

Fillimisht studentët kanë zgjedhur përfaqësuesit e tyre, mandej janë mbajtur zgjedhjet për këshillat e fakulteteve dhe së fundi është konstituuar edhe përbërja e re e senatit të cilët do ta marrin mandatin më 1 tetor 2019.

FSK-ja kryen me sukses operacionin për rimbazhimin e materieve të rrezikshme

Prishtinë, 27 qershor (ER) - Kompania e Mbrojtjes Kimike, Atomike dhe Biologjike (MKAB) e Forcës së Sigurisë të Kosovës (FSK) në një operacion

sfidues ka përfunduar me sukses operacionin për rimbazhimin e materieve të rrezikshme të Kompanisë "Swis Oil" në Pejë.

Pas një pune profesionale, FSK-ja ka arritur që t'i rimbazhohjë gjithsej 322 fuqi, të cilat vlerësohet që tashmë janë në gjendje shumë të mirë. MKAB-ja e

FSK-së së bashku me aktorët mbështetës do ta vazhdojë monitorimin e të gjitha materieve dhe do t'i rekomandojë masat e sigurisë.



Kryeshefi i Telekomit: 'Z-Mobile'-s nuk do t'i vazhdohet kontrata

PRISHTINË, 27 QERSHOR (ER) - Kryeshefi ekzekutiv i Telekomit të Kosovës, Bedri Istrefi, ka bërë me dije se "Z-Mobile"-s nuk do t'i vazhdohet kontrata. Ai përmes një postimi në llogarinë e vet në "Facebook" ka shkruar të enjten se ky njoftim i mosvazhdimi të kësaj kontrate i është adresuar edhe vetë partnerit të Telekomit (Z Mobile) ashtu siç e parasheh edhe kjo marrëveshje. "Strukturat menaxhuese të Telekomit të Kosovës kanë obligim ligjor që në secilën situatë të veprojnë në përputhje të obligimit ligjor të mbrojtjes së interesit të kompanisë sonë. Për më tepër, menaxhmenti ekzekutiv dhe kryeshefi ekzekutiv kanë obligime edhe në raport me të punësuarit e Telekomit. Në këtë drejtim, të hënën gjatë protestës

së Sindikatës së Punëtorëve i kam informuar punëtorët se unë si kryeshef ekzekutiv do të jem në mbështetje të plotë të veprimeve dhe vendimeve me të cilat mbrohen interesat e kompanisë sonë. Siç dihet, çdo partneritet bëhet për përfitime dypalëshe dhe të tilla do të duhej të ishin të gjitha kontratat që kemi me operatorë të ndryshëm", ka shkruar Istrefi, duke shtuar se në frymën e saj, është edhe qëndrimi unanimit i bordit, menaxhmentit ekzekutiv dhe i sindikatës se të gjitha raportet kontraktore me partnerë, pa paragjykuar asnjë prej tyre, do të bëhen dhe vlerësohen sipas parimit të përfitimit të dyanshëm. "Për hir të informimit të drejtë dhe transparencës maksimale dhe për të shmangur çdo keqkuptim të mundshëm,

më duhet të theksoj se kontrata me 'Z - Mobile' nuk do të vazhdohet tutje sipas kushteve të cilat kanë ekzistuar deri më tani, kjo bazuar në konstatimet financiare të ekipeve ndërkombëtare të ekspertëve financiarë dhe të ekipit të ekspertëve ligjorë. Ky njoftim i mosvazhdimi të kësaj kontrate i është dhënë edhe partnerit të Telekomit (Z Mobile) ashtu siç e parasheh kjo marrëveshje. Edhe një herë dua të potencoj se në çdo kohë do të jem përgjegjës për veprimet e mia lidhur me këtë çështje, natyrisht duke qenë në koordinim të plotë me Bordin e Drejtorëve dhe MZHE-në, në mënyrë që çfarëdo veprimi apo edhe vendimi të ketë bazë ligjore dhe të sjellë dobi për kompaninë tonë", ka thënë Istrefi.



Kuvendi miraton Projektligjin për të ardhurat e korporatave

**EPOKA
ERE** Albulena S. MAVRAJ

PRISHTINË, 27 QERSHOR - Me 74 vota për, asnjë kundër, dy abstenime, deputetët e Kuvendit të Kosovës kanë miratuar të enjten Projektligjin në të ardhurat e korporatave. Kompanitë e sigurimeve që operojnë në Republikën e Kosovës tash e tutje do të trajtohen njëjtë sikurse të gjitha bizneset e tjera që funksionojnë në Kosovë. Kështu është thënë në komunikatën e dërguar nga Shoqata e Sigurimeve të Kosovës.

Deri më tash kompanitë e sigurimeve kanë qenë të obliguara që të paguajnë 5 për qind tatim në qarkullim si dhe të gjitha tatimet e tjera që



parashihen me ligjet e Republikës së Kosovës. "Në emër të këtij tatimi kompanitë e sigurimeve janë dëmtuar rëndë. Në mënyrë të padrejtë deri më tash kanë paguar mbi

60 milionë euro. Përfundimisht sot po merr fund një padrejtësi e madhe. Kompanitë e sigurimeve nga sot do të trajtohen njëjtë sikurse të gjitha korporatat e

tjera në Kosovë. Ato do të paguajnë të gjitha tatimet që parasheh ligji, por më nuk do të paguajnë 5 për qind në qarkullim, por do të paguajnë tatim në shkallë prej 10 përqindësh në të ardhurat e tatueshme. Për të ardhur deri këtu është dashur një angazhim i madh i guvernatorit të Bankës Qendrore të Kosovës, Fehmi Mehmeti, Kuvendit të Kosovës, Ministrisë së Financave, por edhe i Shoqatës së Sigurimeve të Kosovës", ka thënë drejtori ekzekutiv i Shoqatës së Sigurimeve të Kosovës, Sami Mazreku. Sipas tij, tatimi i aplikuar deri më tash, përpos që ka dëmtuar rëndë industrinë e sigurimeve në aspektin financiar, si e tillë ka dëmtuar

rëndë edhe ambientin e të bërit biznes.

Mazreku ka thënë se tatimi i tillë ka qenë edhe një barrierë për investitorët e huaj të cilët kanë qenë të interesuar ta investojnë një pjesë të kapitalit të tyre në këtë fushë, pasi është parë si barrë e rëndë financiare. "Me ndryshimin e tatimit për kompanitë e sigurimeve, duke i tatuar sikur të gjitha korporatat e tjera, po hapet një etapë e re e zhvillimit. Gjatë këtij viti, përpos inovacioneve të shumta në industrinë e sigurimeve, ne të gjithë së bashku do të angazhohemi për vetëdijësimin e qytetarëve për ta ulur numrin e aksidenteve me pasoja fatale, por edhe atyre me të lënduar rëndë dhe lehtë", ka thënë Mazreku.

Matoshi: Po shënojmë hapa pozitivë për krijimin e një Kosove të gjelbër

PRISHTINË, 27 QERSHOR (ER) - Ministri i Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor, Fatmir Matoshi, ka marrë pjesë në konferencën "everGreen Kosovo", e organizuar nga "Let's Do It Kosova", kurse financuar nga Kombet e Bashkuara në Kosovë. Në fjalën e tij para të pranishmëve ministri Matoshi ka falënderuar organizatorin e këtij forumi, organizatën "Let's Do It Kosova", si dhe Kombet e Bashkuara për financimin e tij. Matoshi ka theksuar se krahas angazhimit institucional dhe veprimeve konkrete që po ndërmerren për përmirësimin e

gjendjes së mjedisit në vend, adresimi i mirëfilltë i sfidave mjedisore dhe nxjerrja e shtesave të tjera në konferencë të tilla është i mirëseardhur. "Pavarësisht diversitetit në qëndrime dhe opinione rreth aktualitetit mjedisor në vend, besoj se të gjithë pajtohen në të paku tri fakte. 1. Asnjëherë më parë nuk ka pasur angazhim më të madh institucional dhe koordinim për kryerjen e përgjegjësisë ligjore për përmirësimin e gjendjes së mjedisit në vend. 2. Asnjëherë më parë nuk kemi pasur vullnet dhe mobilizim më të madh të shoqërisë civile për adresimin

dhe angazhimit praktik në çështjet mjedisore dhe: 3. Asnjëherë më parë nuk kemi pasur aktivizim dhe vetëdije më të madhe të qytetarëve në mbrojtjen e mjedisit", ka deklaruar ministri Matoshi.

Ai ka thënë se falë këtij angazhimi institucional dhe shoqëror, me përkrahjen e rezervë të donatorëve ndërkombëtarë po shënojmë hapa pozitivë për krijimin e një Kosove të gjelbër që promovon jetën e shëndetshme, mbrojtjen e burimeve tona natyrore dhe përdorimin racional të tyre.

Matoshi u ka bërë thirrje



kryetarëve të komunave, shoqërisë civile dhe qytetarëve, që ta vazhdojnë angazhimin e tyre sepse, sipas tij, nuk mund të

mendojmë për një shoqëri të shëndoshë dhe mirëqenie sociale nëse nuk kemi një mjedis të pastër.

Mjekët e Qendrës Emergjente në Prishtinë trajnohen për trajtimin e infarktit

PRISHTINË, 27 QERSHOR (ER) - Komuna e Prishtinës ka bërë me dije se me mbështetjen e dr. Bujar Gashit, drejtor për Shëndetësi, mjekët dhe infermierët e Qendrës së Mjekësisë Urgjente janë duke u trajnuar për programin nacional të trajtimit të infarktit akut të miokardit.

Ky program kombëtar parasheh që në rast të infarkteve akute të bëhet reagimi dhe raportimi i shpejtë i rasteve dhe pacienti brenda 120 minutave të marrë trajtimin e duhur. "Duke u trajnuar mjekët e mjekësisë primare, sigurohet që pacientët ta marrin shërbimin dhe trajtimin adekuat qysh me fillimin e simptomave të para dhe brenda

120 minutave të arrihet të shpëtohet muskuli i zemrës dhe pacientët të mos mbeten me invaliditet. Një falënderim i veçantë për dr. Tefik Bekteshi, drejtor i Klinikës së Kardiokirurgjisë me Kardiologji Invazive për gatishmërinë dhe angazhimin maksimal për shpërndarjen e përgatitjes profesionale të pjesëmarrësit e trajnimit", ka njoftuar Komuna e Prishtinës.

Sipas këtij njoftimi, statistikat tregojnë se rreth 3 000 persona apo 35 për qind e të gjitha vdekjeve brenda vitit në Kosovë shkaktohen nga sëmundjet e zemrës. Për çdo vonesë prej 30 minutash pas infarktit, rreziku i vdekshmërisë rritet për 7.5 për qind.



QKMF-ja në Drenas pranon pajisje mjekësore në vlerë prej 80 mijë eurosh



DRENAS, 27 QERSHOR (ER) - Qendra Kryesore e Mjekësisë Familjare (QKMF) në Drenas "Dr. Hafir Shala" ka pranuar aparaturë mjekësore për të gjithë sektorët e mjekësisë familjare. Në kuadër të këtij donacioni, kjo qendër ka pranuar dy analizërë biokimikë, dy karrige stomatologjike, një aparat të "CTG"-së, një aparat të "RTG dental" dhe një aparat oksigjeno-koncentrorë. Këto pajisje mjekësore janë

dhuruar në kuadër të donacionit përfitues të Ministrisë së Shëndetësisë (MSh) për Komunën e Drenasit në vlerë të përgjithshme mbi 80 mijë euro. Në kuadër të këtij donacioni përfitues, në ditët në vazhdim do të sillen edhe pajisje të tjera: tre oksigjeno-koncentrorë, pesë aparate "EKG", një aparat për ultrazë ginekologjik, pesë aparatura hematologjike (numërues) dhe tre shtrretër për sallën e lindjes.

Këto pajisje janë donacion sipas kërkesës me projekte të Komunës së Drenasit drejtuar në Ministrinë e Shëndetësisë, bazuar në Udhëzimin Administrativ të MSh-së nr. 08/2017, si pajisje të domosdoshme për punë normale, profesionale-shëndetësore. QKMF-ja në Drenas do të pajiset shumë shpejt edhe me mamograf, donacion nga qeveria japoneze që ka vlerën rreth 70 mijë euro.

Komuna e Prizrenit dhe Caritasi zviceran ndihmojnë kultivuesit e mjaltit

PRIZREN, 27 QERSHOR (ER) - Komuna e Prizrenit, në bashkëpunim me Caritasin zviceran, kanë bërë shpërndarjen e mjeteve të punës për prodhimin e mjaltit për 16 bletarë përfitues nga projekti "Prosperiteti i prodhimtarisë agrare në Kosovë nga investimet e qëndrueshme rurale-pasuri". Përfituesit kanë participuar me 15 për qind për ndarjen e granteve, ndërsa

Caritasi zviceran dhe Komuna e Prizrenit kanë participuar me 50 për qind, përkatësisht 35 për qind të shumës së përgjithshme.

Mjetet e shpërndara të enjten, ku ka marrë pjesë edhe kryetari Mytaher Haskuka, janë vetëm një pjesë e mbështetjes për fermerët nga ky projekt, pasi kosheret me shoqëri të bletëve dhe disa mjete të tjera shtesë do të ndahen gjatë javës në bletishtet e përfituesve,

ku më pas edhe do të testohen dhe do të ofrohen trajnime se si të përdoren ato.

Nga ky projekt, që është implementuar nga Caritasi dhe është mbështetur nga Drejtoria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, përveç 16 bletarëve, janë përfitues edhe dy fermerë për kultivimin e boronicës dhe dy të tjerë për kultivimin e bimëve mjekësore.



Konfiskohen dhe asgjësohen produkte pa afat në Klinë

KLINË, 27 QERSHOR (ER) - Drejtoria e Inspektoratit në Komunën e Klinës, përkatësisht inspektorët komunalë, duke iu përgjigjur shqetësimeve të qytetarëve, janë duke vazhduar aksionin e kontrollit të qendrave të mëdha tregtare dhe dyqaneve për afatin e skadimit të mallrave, kryesisht ushqimore, me qëllim të mbrojtjes së qytetarëve. Gjatë inspektimit është asgjësuar një sasi e madhe

e mallit, aty ku është hasur në artikujt pa afat dhe të dëmtuar. Me këtë rast, drejtori i Inspektoratit, Petrit Bekaj, ka ftuar qytetarët që nëse hasin në produkte jo vetëm ushqimore, me afat të skaduar, t'i njoftojnë inspektorët komunalë. Gjithashtu, inspektorët e Klinës kanë lutur të gjitha bizneset e kësaj komune që t'i respektojnë dispozitat e nenit 17 të Ligjit për mbrojtjen e konsumatorit.



Rreth librit 'Prerja e frikës' i autorit Fehmi Pireva



Salihe SALIHU, PhD dhe veprimtare

"Prerja e frikës" është një roman, në të cilin lexuesi gjen një ciklon ndjenjash të autorit që në mënyrë të rrjedhshme janë strukturuar e përmbledhur përjetimet e tij në hapësirat ku autori ka jetuar, aty rreth lumit Llap dhe malit Kulinë. Po ta shohim sfondin e këtij narrativi shihet se, përpos perspektivës historike, lexuesi menjëherë gjen perspektivën kulturore dhe sociologjike mbi ngjarjet e ndodhura meqë aty dalin skena tipike tradicionale shqiptare të cilat janë të ngulitura në kujtesën e autorit që në moshën e re.

Ky rrëfim i gdhendur është pjesërisht i nxjerrë nga përditshmëria, ndërsa pjesërisht kombinohet me imagjinatën e

një fëmije duke u përpjekur që të risjellë të kaluarën me një përshkrim të kujdesshëm. Përshkrimi i të kaluarës është i mbushur me traditat dhe zakonet, ku shtjellohet përditshmëria e mënyrës së jetesës duke lakuriqësuar elementet kulturore dhe sociologjike me paraqitjen e kodeve të shkruara e të pashkruara të cilat ishin në funksion të jetës së shqiptarëve.

Po ashtu, në këtë përshkrim dallohet një karakteristikë e veçantë që autori përdor duke pajisur perspektivën historike jo vetëm përmes përjetimeve të veta, por edhe përmes përjetimeve të paraardhësve. Me mjeshhtëri autori rikthehet në kujtimet te përrallat e gjyshes, duke bërë një shfletim të kujtesës së tij, duke e bërë mjaft të këndshëm përshkrimin.

Autori nga rrëfimi i përrallave nxjerrë në pah heroizmin dhe prijësin e popullit tonë - heroin kombëtar Skënderbeun dhe luftërat e popullit tonë kundër okupuesve. Nga ky segment shohim se si historia aq e largët afrohet dhe bashkohet me tregimet e historisë së afërt, e

që producent të kësaj historie të freskët janë brezat e njëpasnjëshëm që u angazhuan për lirinë e këtij vendi.

Perspektiva historike, e mbështjell me dimensionin kulturor e sociologjik, përmes fabulës "Prerja e frikës", në mënyrë interaktive është inkorporuar me dimensionin psikologjik.

Në këtë gërshetim të perspektivave është shkoqitur në mënyrë të hollësishtme përditshmëria e jetesës së shqiptarëve. Por, sido që ta analizojmë këtë përshkrim, ne nuk mund ta ndryshojmë të kaluarën që autori e përshkruan. Prandaj, ky pasqyrim jetësor me përfshirjen e këtyre elementeve do të jetë në shërbim për brezat e rinj, për pasardhësit tanë, që të pajisen me njohuri se në çfarë mënyre e në çfarë kushte kanë jetuar paraardhësit e tyre. Veçanërisht, ky përshkrim mund t'u shërbejë pasardhësve që të seleksionojnë se çfarë mund të ruhet nga tradicionalet dhe se çfarë duhet braktisur njëherë e përgjithmonë si, për shembull, veprimet misterioze, siç ishte prerja e frikës gjë që

është edhe mesazhi i vet autorit.

Autorin në fëmijërinë e tij e kanë tmerruar sjelljet misterioze për "Prerjen e frikës" dhe për ta çrrënjësuar këtë dukuri të mistifikuar autorit iu nevojiti që ta sjellë në këtë rrëfim paraqitjen e intelektualëve që me iluminizmin e tyre i bënë varrin dhe larguan shumë zakone të dëmshme që ngulfatën zhvillimin e dijes dhe prosperitetit në trojet tona.

Figurat iluministe paraqiten jo vetëm për përmbysjen e zakoneve të këqija, por edhe për rezistencën e tyre ndaj okupimit, duke i përshkruar si njerëz të sakrificës që, pavarësisht prej burgosjeve dhe maltretimeve, nuk u mposhtën, por vazhduan si pishtarë lirie për të sjellë një fije drite të rrezeve të lirisë në trojet e përvuajtura.

Përmes romanit "Prerja e frikës" gjejmë dialektikën jetësore të shqiptarëve dhe hapat e tyre vetëdashës për t'i braktisur format mitologjike të jetesës dhe për t'i kultivuar vlerat civilizuese në këto troje. Autori në përshkrimet e vlerave

civilizuese thotë: "Me kaq marrin fund edhe trillet e plakave...", gjithashtu më pastaj autori inkurajon zhvillimin e individit duke dhënë porosinë: "Duhet të mësosh të ecësh vetë...". Këto formulime flasin vetvetiu se çfarë autori synon të përçojë te lexuesi.

Duke e përgëzuar autorin për këtë roman mund të them se autori ka arritur t'i paraqesë ndryshimet historike të ndodhura nëpër kohë si në aspektin kulturor, sociologjik dhe psikologjik, të cilat në mënyrë të vetëdijshme e me plot sakrificë u kultivuan te ne. Në fund mund lirshëm të them se mesazhi i romanit pikë të fortë ka transformimet civilizuese të cilat janë nxitur nga intelektualët shqiptarë që aspironin një jetë sa më çmisticifikuese dhe sa më humane. Uroj që të shtohet numri i krijimeve prozaike me mesazhe të tilla, për një të ardhme më të ndritshme dhe larg e më larg nga "Prerja e frikës" sikurse janë përfshirë në këtë roman.

Prishtinë,
25 qershor 2019


Armagedoni boton monografinë për dramën e Qosjes

PRISHTINE, 27 QERSHOR - Studiuesi i dramës, Berat Dakaj (alias Armagedoni), ka botuar sot librin studimor "Dramat e Qosjes: (monografi)", të cilin para disa vjetësh e ka pasur punim të diplomës së masterit, paraqitur dhe mbrojtur në Fakultetin e Arteve Dramatike të Universitetit të Prishtinës "Hasan Prishtina", nën udhëheqjen e mentorit, prof. dr. Haqif Mulliqit.

Në këtë monografi janë analizuar, interpretuar dhe studiuar dramën e Rexhep Qosjes me titull *Mite të zhveshura*, në të cilën përmbledhje të dramave, në

botimin e parë dhe të dytë të tyre, janë përfshirë dy drama dhe një monodramë, kurse në botimin e tretë dhe të katërt edhe një monodramë tjetër, e cila nuk është marrë për studim në këtë monografi pasi, sipas Armagedonit, është dramë shumë e thjeshtë artistike dhe është dramë me motive krejtësisht politike.

Në hyrje të këtij libri autori ka shkruar: "Duke e parë evoluimin e poetikës dramatike, për të hartuar një punim shkencor të këtij lloji, para studiuesve të dramaturgjisë do të shtrohet nevoja edhe për njohjen e:



estetikës, të stilistikës, të lingvistikës, të sociolingvistikës, të gjenetikës e për shumë disiplina të tjera të letërsisë; për shumë rryma letrare si për: realizmin, simbolizmin, natyralizmin, ekspresionizmin, avangardizmin etj., të cilat, ani pse periudha të veçanta në të gjitha artet, janë të pranishme në letërsinë dhe dramën moderne, në masë të madhe, të shumtën e herëve për tallje, në letërsinë dhe dramën postmoderne. Kjo nevojë për njohje të tyre do të shtrohet, pasi vepra artistike, në këtë rast drama, nuk ka vetëm rregulla poetike dhe teknike, por ka edhe gjuhësore, të cilat, po të thuren mirë, po t'i kenë në vete e t'u përmbahen parimeve poetike të cilësdo prej


këtyre periudhave, i japin vlerë të madhe veprës dramatike. Në këtë bashkëjetesë kaq të madhe të periudhave duhen parë edhe dramën e Qosjes, pasi në to përfshihen elemente të të gjitha periudhave letrare".

Kjo monografi s'është ndarë në kapituj, por emërtimi i njësive dhe ndarja e tyre u ngajjnë kapitujve. Në fillim të librit është dhënë shpjegimi për dramën, për origjinën e dramës, për nocionet e dramës, për poetikën dhe evolucionin e saj ndër shekuj. Po në këtë kontekst teorik dhe historik për poetikën e dramës janë dhënë mendimet e Aristotelit, të Baluhatit, të Platonit, të Hegelit e disa shpjegime të tjera të shkëputura nga fjalorët shqip dhe anglisht për mimesisin dhe katarsisin, pastaj disa shpjegime të librave teorikë për dramën në përgjithësi.

Së këndejmi, duke marrë njohuri teorike nga këta teoricienë të teatrit e të dramaturgjisë, janë analizuar praktikisht dhe veç e veç dramën e Qosjes, *Sfinga e gjallë*, *Besëlam pse më flijojnë*, *Vdekja e një mbretëreshë*, jo edhe *Bardha* e tij, të cilat janë përfshirë në *Mite të zhveshura*. Ndër të tjera, meqë dramave të tij u paraprijnë peritextet, janë analizuar edhe ata, pasi nëpërmjet tyre është parë ajo çfarë

shprehin dramën e tij dhe ato çfarë kanë dashur të shprehin ose mund të kenë shprehur gjatë shfaqjes së tyre në teatër regjisorët me rastin e realizimit të tyre në teatër. Dhe meqë këto drama kanë motive intertekstuale dhe janë të motivueshme politikisht, janë vënë në raport krahasimi me ato që u shëmbëllojnë: me arketipat, të cilët kemi vënë re se kanë pësuar transformim zhanror.

Përpos kërkimit të gjenezës së intertekstit e arketipave e shfaqjes së tyre në dramën e Qosjes, është bërë edhe një kërkim gjenetik i botimit të tyre, duke i parë variantet e tyre botim pas botimi. Ndërkaq, duke pasur parasysh ribotimin e tyre, të shumtën e herëve nga dy mijë ekzemplarë, kemi kërkuar, ndërkohë edhe ballafaquar me të tjerët dhe me këtë libër, edhe tekste kritike dhe interpretimet e ndryshme të studiuesve shqiptarë të letërsisë shqipe bërë dramave *Mite të zhveshura*, por edhe të atyre kritikëve bërë shfaqjeve teatrore të këtyre dramave, të realizuara në teatrot e Kosovës, disa prej tyre edhe në disa festivale teatrore të Serbisë, prezantuar në shtypin ditor dhe periodik, disa prej tyre të përmbledhur veçanë në libra.



Trumpi arrin në Japoni

OSAKA, 27 QERSHOR - Presidenti i ShBA-së, Donald Trump, ka arritur të enjten në Japoni për të marrë pjesë në samitin e vendeve më të industrializuara G20. Presidenti amerikan pritet të mbajë të paktën tetë takime bilaterale duke filluar me takimin e parë që do të zhvillohet me kryeministrin australian Scott Morrison. Trumpi pritet të takohet me presidentin rus Vladimir Putin, presidentin kinez Xi Jinping, presidentin turk Rexhep Tajip

Erdogan dhe princin e kurorës së Arabisë Saudite, Mohammed bin Salman. Ai do të mbajë takime edhe me kancelaren gjermane Angela Merkel dhe kryeministrin japonez Shinzo Abe.

Trumpi u tha gazetarëve kur u largua nga Shtëpia e Bardhë se ai pret një bisedë shumë të mirë me Putinin, por shtoi se "ajo që unë i them atij, nuk është punë e juaj". Përveç Iranit, Trumpi dhe Putini pritet të diskutojnë për Sirinë dhe

Venezuelën si dhe armët bërthamore.

Trumpi anuloi një takim të planifikuar me Putinin në Argentinë në nëntor të vitit 2018 pasi Rusia konfiskoi dy anije ukrainase dhe ekuipazhin e tyre.

Sa i përket Kinës, qëllimi kryesor i Trumpit gjatë takimit të tij me Xi Jinping do të jetë rivendosja e negociatave tregtare midis ShBA-së dhe Kinës pasi ato u pezulluan më parë gjatë këtij viti.



Kandidatët presidencialë përplasen rreth migrimit në ShBA

WASHINGTON, 27 QERSHOR - Kandidatët demokratë për president të Shteteve të Bashkuara janë përplasur rreth sistemit të sigurimit shëndetësor dhe politikave për kufirin në debatin e parë që është mbajtur gati 16 muaj para se amerikanët të votojnë.

Në raundin e parë të debateve shumë kandidatë që nuk kanë shumë nam kanë synuar të fitojnë vëmendje ashtu që ta mposhtin presidentin aktual, Donald Trump, në zgjedhjet e nëntorit të vitit 2020, transmeton agjencia e lajmeve "Reuters". Ata kanë sulmuar vazhdimisht Trumpin, duke thënë se politikat ekonomike të tij janë rezultat i punës së madhe të amerikanëve dhe kanë konsideruar qasjen e tij për kufirin si tejet të ashpër. "Më 20 janar 2021 ne i themi 'lamtumirë' Donald Trumpit", ka thënë kandidati Julian Castro.

Mirëpo ata kanë dalë kundër qëndrimeve të njëri-tjetrit, duke shënjestruar kryesisht, kandidatin Beto O'Rourke. Ish-kongresisti është përplasur me Castron për politikën rreth kufirit si dhe me kryetarin e Nju-Jorkut, Bill de Blasio, në çështjet shëndetësore, ka njoftuar rfe.

Beteja për sigurim shëndetësor ka nisur kur kandidatët janë pyetur ta ngritin dorën nëse do ta mbështesnin eliminimin e sigurimit privat shëndetësor. Vetëm senatorja Elizabeth Warren dhe de Blasio

janë pajtuar për t'i sfiduar tetë kandidatët e tjerë në skenë.

Warren, lidere e krahut progresiv të partisë, ka thënë se siguria privat shëndetësor është duke përfutur nga amerikanët. Prandaj ajo ka mbështetur sigurimin shëndetësor të sponsorizuar nga qeveria dhe ka kritikuar atë që besojnë se një gjë e tillë nuk është e mundshme. "Çfarë thonë ata është se nuk do të luftojnë për këtë çështje. Sigurimi shëndetësor është e drejtë bazike dhe unë do të luftoj për këtë", është shprehur ajo.

Ish-përfaqësuesi amerikan, John Delaney, një kritik i ashpër i konceptit për sigurim shëndetësor të siguruar nga shteti, ka thënë se demokratët nuk duhet të eliminojnë një sistem me të cilën janë të kënaqur disa amerikanë. "Besoj se ne duhet të jemi partia që mirëmban atë që është duke funksionuar dhe rregullon pjesët e dëmtuara", ka deklaruar, Delaney.

Sigurim shëndetësor për të gjithë, politikë e shtyrë përpara nga Warren dhe kandidati tjetër, Bernie Sanders, që ka fituar edhe përkrahje në Kongres, parashih krijimin e një plani të drejtuar nga qeveria, që eliminon sistemet private të sigurimit shëndetësor.

Debat i mërzitshëm?

Kandidati O'Rourke është sulmuar nga garuesi tjetër Castro



edhe rreth ndarjes së familjeve dhe ndalimit të migrantëve në kufirin jugor me Meksikën. Castro ka thënë se do t'i legalizonte kalimet kufitare të migrantëve, pasi një vendim i kundërt ka rezultuar me ndarje të familjeve dhe ka kërkuar ndihmën e kandidatëve tjerë. O'Rourke ka thënë se si kongresist ka ndihmuar në hartimin e një projektligji, që do t'i siguronte ata që kërkojnë azil apo statusin e refugjatit në ShBA, nuk do të ndalohen. Castro në anën tjetër i është përgjigjur: "Nuk jam duke folur për ata që kërkojnë azil, por për gjithë të tjerët".

Presidenti Trump ka thënë para se të niste debati se nuk do ta komentonte atë në rrjetin social, "Twitter".

Mirëpo pak kohë pasi kanë nisur diskutimet, ai ka postuar vetëm një fjalë: "E mërzitshme". "Ky debat ka qenë argumentimi më i mirë për rizgjedhje të presidentit Trump", ka thënë zëdhënësja e fushatës së Trumpit, Kayleigh McEnany më vonë. Ky debat është konsideruar mundësi për disa kandidatë, që të largohen nga hija e kandidatit Joe Biden, që ka mbajtur pozitën e nënkryetarit të shtetit gjatë udhëheqjes së ish-presidentit Barack Obama, apo edhe senatorit Bernie Sanders.

Fushata për zgjedhjet e vitit 2020 pritet të jetë një nga organizimet më të shtrenjta dhe më të ashpra në historinë e zgjedhjeve amerikane.

Një gjë e tillë është thënë të jetë reflektim i politikave të Trumpit gjatë udhëheqjes së tij. Sipas së përditshmes "The New York Times", senatori Cory Booker ka pasur më së shumti kohë për t'i prezantuar idetë e tij, në total 11 minuta, duke u përcjell nga O'Rourke, Warren dhe Castro.

Numri i kandidatëve demokratë do të fillojë të zvogëlohet në shkurt të vitit 2020, kur shtetet të fillojnë ta mbajnë rrethin e parë të zgjedhjeve, çka do të rezultojë edhe me nominim të një kandidati.

Trumpi, në anën tjetër, deri më tash ka vetëm një kundërkandidat në radhët e republikanëve: një ish-gubernur shteti.

Abe fton presidentin kinez për vizitë shtetërore në Japoni

OSAKA, 27 QERSHOR - Kryeministri japonez Shinzo Abe ftoi të enjten presidentin kinez Xi Jinping që të rikthehet në Japoni si një i ftuar i shtetit vitin tjetër gjatë bisedimeve që zhvilluan në qytetin perëndimor të Japonisë, Osaka në kuadër të Samitit të G20.

Pranimi i kësaj ftese nga Xi shi-

het edhe si një shenjë e zbutjes së marrëdhënieve shpesh herë të ashpra mes dy vendeve aziatike. "Është një ide e mirë për mua që të bëj një udhëtim në Japoni pranverën e ardhshme", i tha presidenti kinez Abesë gjatë takimit në kuadër të Samitit të G20-s në Osaka.

Xi, i cili mbërriti të enjten në

mëngjes për samitin, vizitonte Japoninë për herë të parë që kur ka ardhur në pushtet në vitin 2013. Abe i shprehu presidentit kinez se "Japonia është e gatshme të punojë bashkë me Kinën, partneri më i madh tregtar i vendit, për t'i ngritur marrëdhëniet mes dy vendeve në një dimension të ri".



Sylejman Sylejmani i lindur në vitin 1873 në Cernicë dhe i ndarë nga jeta në vitin 1924 po në Cernicë! Ky burrë i madh e i lavdishëm, përfaqësuesi më në zë i fisit e i familjes tonë, nga gjaku ynë është i pari dalëzotës e famëm i fateve të Atdheut, ku nën komandën e Komandantit legjendar Idriz Seferi luftoi me armë kundër hordhive turke. Pavarësinë e Atdheut e mbrojti me armë në duar kundër Perandorisë Osmane!

LETËR STËRGJYSHIT LUFTËTAR



Ismet SYLEJMANI

I dashur dhe i nderuar stërgjyshi ynë Baba Sylë,
146 vite pas lindjes Tënde e 95 vite nga vdekja Jote dhe në 20 vjetorin e çlirimit të Kosovës nga Serbia pushtuese, një rrugë në lagjen e fshatit Tënd të lindjes në Cernicë, është emruar me emrin Tënd!
Çfarë krenarie për neve

stërnipërit Tuaj që ishim të radhitur me pushkë në duar në Ushtrinë Çlirimtare të Kosovës, e me kontribute edhe në UÇPMB e në Ushtrinë Çlirimtare Kombëtare!

Por krenari është edhe për shokët e bashkëluftëtarët tanë, për themeluesit, komandantët e ushtarët e lavdishëm të UÇK-së, sepse ata te Ti dhe stërgjyshërit e gjyshërit, baballarët dhe të tjerë pararendës të tyre, shohin paraardhësit e mëdhenj që na e shtruan rrugën dhe na e bënë të kristaltë historinë për të luftuar e për të mos u dorëzuar as kundër armikut dhe as kundër tradhtarëve të vendit!

I dashur dhe shumë i nderuar Babloku ynë, në Kosovën e Lirë e

të pavarur, në mesin e emrave të shumtë që u janë vënë rrugëve nga ata që kanë derdhur gjak e që kanë luftuar për lirinë dhe çlirimin e Atdheut, është edhe emri Yt i madh, që për ne pasardhësit tuaj përbën një nderim të madh e maksimal luftarak çlirimtar, kombëtar e shtetërorë!

I dashur dhe shumë i nderuar Baba Sylë!

Nga të parët tanë që na e lanë me gojë trashëgim historinë, e dijmë o Baba Sylë, se babai Yt Hajdini shkoi në luftë në vend të Mixhës Hazir, dhe në betejën në Plevën të Bullgarisë edhe u vra atje sëbashku me shumë shqiptarë të tjerë që i lanë kockat, e Ti i dashur dhe shumë i nderuar Bablok mbete jetim e u rrite në

Velekincë me bukë nga dera bujare e familjes Abdyli të dajëve Tu, me shumë vuajtje të rriti e me besnikëri Lokemadhja Arife!

Ti stërgjyshi ynë i madh Baba Sylë, duke dëgjuar për rënien heroike të babait Tënd Hajdini në betejat antinjerëzore e për llogari të perandorëve osman, i brumosur me dashuri ndaj Atdheut në derën bujare të dajëve në Velekincë e nise luftën çlirimtare me pushkë në dore kundër perandoreve osmanlinjë e krajëve serb!

Ne stërnipërit Tu, për të nderuar emrin e madh dhe të lavdishëm që na e ke lënë trashëgim Ti, iu futëm luftës për liri me gjithë shpirtë e zemër, nuk u kursuem dhe deshi fati që nuk u vramë në

luftë, ndonëse shumë shokë e bashkëluftëtarë kanë derdhur gjakun dhe janë Dëshmorë e Heronjë të Kombit!

Tash Kosova Atdheu ynë i dashur dhe i shtrenjtë është e lirë dhe e pavarur nga Serbia pushtuese!

Prandaj stërgjyshi Ynë, të nisim letër e të njoftojmë atje në qiell ku je, se në hartën e emrave të rrugëve të Kosovës është edhe emri Yt lavdimadh, që për neve pjestarët vazhdues të drejtëpërdrejtë të gjakut Tënd, është nderim i madh dhe obligim përgjithmonë karshi fateve dhe intereseve të vendit!

Jemi me fat që jemi vazhduesit e ADN-së Tënde!

Lavdi e përjetshme!

Cernicë, 27 Qershor 2019!



E rrallë

Kush këput zambakun 'Mis - Akkus Lily' në Turqi merr gjobë 9 000 euro

Autoritetet turke kanë njoftuar se kush këput zambakun 'Mis - Akkus Lily' do të paguajë një gjobë prej 9 000 eurosh. Lloji i parë i bimës është zbuluar në vitin 1993 në qytetin Ordu të Turqisë. Ordu që ka një florë të pasur, është shtëpia e mbi 700 llojeve të bimëve të regjistruara, 130 prej të cilave janë endemike.



FOTO E DITES



Diplomimi i kadetëve të Forcës së Sigurisë së Kosovës (FSK), gjenerata 2019

E jashtëzakonshme

Kapen mbi 5 000 breshka kontrabandë në aeroport

Autoritetet malajziane kanë kapur më shumë se 5 000 breshka të vogla të zbuluara në bagazhet në aeroportin e Kuala Lumpur. Lidhur me këtë rast janë arrestuar dy indianë. Zyrtarët e aeroportit kanë thënë se breshkat



kanë vlerë rreth 12 700 dollarë dhe kishin për qëllim të shiteshin si kafshë shtëpiake në Indi.

BARSOLETA E DITËS



Burrë dhe grua flasin për pushimet por, para se të vendosin, shohin nëse kanë buxhet. Pasi e analizojnë buxhetin, burri thotë:
- Valla unë nuk kam nevojë për pushime, se nuk jam aspak i lodhur.
Gruaja:
- Valla as unë, se po ndihem shumë në formë.



Programi i shfaqjes së filmave në Kino ABC

Ne ora 16:00 (vikendit ne ora 14:00 dhe 16:00)
"THE SECRET LIFE OF PETS 2" 3D

I Animuar/Aventurë/Komedi; 1 ore 26 min
Rolet: Kevin Hart, Tiffany Haddish, Harrison Ford, Patton Oswalt, Eric Stonestreet, Jenny Slate, Lake Bell, Hannibal Buress, Nick Kroll, Dana Carvey, Ellie Kemper, Pete Holmes, Garth Jennings, Bobby Moynihan
Regjia: Chris Renaud and Jonathan Del Val



Ne ora 18:00
"X-Men; Dark Phoenix"

Aksion/Aventurë/Sci-Fi; 1 orë 53 min


Rolet: James McAvoy, Michael Fassbender, Jennifer Lawrence, Nicholas Hoult, Sophie Turner, Tye Sheridan, Alexandra Shipp, Kodi Smit-McPhee, Evan Peters, and Jessica Chastain
Regjia: Simon Kinberg



Në ora 20:00

"MEN IN BLACK; INTERNATIONAL" 3D,
Aksion/Komedi/Sci-Fi; 1 orë 55 min

Rolet: Chris Hemsworth, Tessa Thompson, Kumail Nanjiani, Rebecca Ferguson, Rafe Spall, Laurent Bourgeois, Larry Bourgeois, Emma Thompson, Liam Neeson
Regjia: F. Gary Gray



Ne ora 22:00

"M A"

Horror/Triller; 1 ore 39 min

Rolet: Octavia Spencer, Juliette Lewis, Diana Silvers, Luke Evans, McKaley Miller, Missi Pyle, Corey Fogelmanis, Gianni Paolo, Dante Brown
Regjia: Tate Taylor



Për informata dhe rezervime të biletave thirrni FALAS: 0800 22 222 dhe boxoffice@kinoabc.info, www.kinoabc.info, fb: Kino ABC.




DASHI

Me kalimin e kohës edhe energjitë tuaja kanë rënë. Nuk do të jeni në gjendje të ndiqni më të njëjtat ritme si më parë projekte të caktuara.



DEMI

Ka qenë një periudhë jo mjaft e mirë nga ana sentimentale dhe duhet të filloni të rivlerësoni persona të caktuar.



BINJAKËT

Edhe pse kërkonti ndryshime në jetën tuaj, përsëri kenë drojë ta merrni hapin e parë dhe ta hidhni pas krahëve situatën aktuale.



GAFORRJA

Kaloni pengesat e vogla që kenë me njerëzit pranë jush sepse sot më shumë se kurrë ju duhet bashkëpunim. Nëse veproni drejt do të merrni përfitime.



LUANI

Këtë periudhë jeni të përqendruar në mbarëvajtjen e çështjeve tuaja profesionale dhe nuk doni të dëgjoni asgjë tjetër.



IRGJËRESHA

Kenë zgjedhur të bëni shumë gjëra njëkohësisht sot, por nuk do të thotë që duhet t'i përfundoni të gjitha njëherësh.



PESHORJA

Edhe pse kenë bërë kompromise në të shkuarën, në situatën aktuale nuk ju pëlqen aspak të bëni kompromis me dikë.



AKREPI

Vërtet nuk do të ndihmoni personalisht një mikun tuaj, por do ta gjeni mënyrën që persona të tjerë të merrin me çështjen e tij të ndërlikuar.



SHIGJETARI

Dikush pret që ta përfshini në një çështje të caktuar, por ju nuk jeni shumë të bindur në aftësitë e tij. Do të bëni çmos të mos i bini në sy.



BRICJAPI

Duhet të krijoni një jetë tuaj personale që s'ka lidhje me punën apo studimin. Jo çdo gjë është e kufizuar vetëm në çështje financiare apo studimore.



UJORI

Mos u mundoni të merrni hak për padrejtësitë që ju kanë bërë në të shkuarën. Do të ishte thjesht një humbje kohe për ju dhe për personat që ju duan.



PESHQIT

Nëse nuk doni t'i lejoni persona të caktuar të afrohen me ju, mos kërkonti prej tyre favore që nuk mund t'ju plotësojnë.

Vdes aktori Billy Drago



Billy Drago ka ndërruar jetë në moshën 73-vjeçare. Aktori i njohur vdiq të hënën në Los Angeles nga ndërlikimet e një sulmi shëndetësor. Karriera e tij që zgjati katër dekada, e pa

aktorin të shfaqet në më shumë se njëqind filma, përfshirë Clint Eastwood's Pale Rider. Ai, po ashtu, u shfaq edhe në shumë emisione televizive, përfshirë Charmed dhe X-Files.

Këngëtari i njohur rikthehet në scenë pas katër vjetëve mungesë



Michael Buble është rikthyer në scenë pas një pauze katërvjeçare dhe aktualisht po zhvillon koncertin e gjashtë të turneut të tij, "An Evening with Michael Buble". Këngëtari kanadez do

të interpretojë gjatë këtij turneu, shumë prej këngëve të albumit të tij, të dhjetë muzikor, "Love", i cili doli në treg vitin e kaluar. Turneu përfshin gati 100 performanca në Amerikën e Veriut, Australi dhe në Evropë.



Era në krye të toplistave në Rusi

Këngëtarja nga Kosova, Era Istrefi, ka publikuar ditë më parë një bashkëpunim me reperin rus Allj. "Sayonara Babe" vetëm pesë ditë pas publikimit

është renditur e para në Apple Music. Lajmin e ka bërë me dije vetë këngëtarja përmes një postimi në profilin e vet në "Instagram".

Shtrohet në spital aktori i famshëm turk



Aktori i famshëm turk, Kivanc Tatlitug, është shtruar në spital pasi u helmua nga ushqimi. Yllit të kinematografisë turke i është pastruar stomaku. Tatlitug, i cili humbi babanë e tij

Ali Cengiz Dizer në fundjavë, u ndje keq të mërkurën në darkë. Ai u dërgua në një spital privat nga shoferi i tij në Ulus. Pas u mbajt nën vëzhgim nga mjekët, aktori u dërgua në shtëpi.

EURO GLASS
 SAINT-GOBAIN
 SEKURIT PILKINGTON
 Enveri
 Adr: Fushë Kosovë
 Mob: 044 10 20 10 / 049 145 336
 E-mail: euro.glass@live.com





QENDRA SPORTIVE

"BUJQËSIA"

TEL: 045/82 82 82

Ditë e madhe për sportistët dhe artistët

Sportin dhe kulturën në Kosovë i presin ditë të mira pasi të enjten është votuar nga 74 deputetë Ligji për Tatim në të Ardhurat e Korporatave. Ministri i MKRS-së, Kujtim Gashi, ka parashikuar se me implementimin e këtij ligji sportistët do t'i sjellin Kosovës me shumë medalje dhe artistët me shumë çmime ndërkombëtare. "Implementimi i Ligjit për Sponsorim do të thotë, sport më cilësor, prezantim më i suksesshëm i sportistëve në arenën ndërkombëtare dhe promovim i mëtejshëm i Kosovës ndërkombëtarisht, më shumë medalje për sportistë e më shumë çmime ndërkombëtare për artistë", ka thënë Gashi



EPOKA E RE **Veton ZYMBERI**

PRISHTINË, 27 QERSHOR - Për sportin dhe kulturën në Kosovë data 27 qershor do të mbetet në histori, pasi deputetët e Kuvendit të Kosovës me 74 vota për e votuan amendamentin 5 të Ligjit për Sponsorime në Fushën e Kulturës, Rinisë dhe Sportit, me Projektligjin për Tatimin në të Ardhurat e Korporatave. Në dy herët e kaluara ky ligj nuk kishte kaluar për faktin se i kishte marrë 60 vota, përkatësisht 55 vota. Pas miratimit të këtij ligji, ministri i Kulturës, Rinisë dhe Sportit, Kujtim Gashi, ka thënë se tash e tutje Kosova do të ketë prezantim edhe më cilësor të sportit në arenën ndërkombëtare, por edhe më shumë çmime ndërkombëtare nga artistët. "Kështu, nga sot, me fillimin e zbatimit të ligjit në fjalë, do të mundësohet që rreth 30 milionë euro të sponsorizohen brenda një viti për zhvillimin e sportit, rinisë, artit e kulturës. Implementimi i Ligjit për Sponsorim do të thotë, sport më cilësor, prezantim më i suksesshëm i sportistëve në arenën ndërkombëtare e kështu promovim i mëtejshëm i Kosovës ndërkombëtarisht, më shumë medalje për sportistë e më shumë çmime ndërkombëtare për artistë", ka thënë Gashi, i cili ka rikujtuar se me të marrë drejtimin e MKRS-së kishte filluar punën për ta hartuar rregulloren përkatëse, komisionin për vërtetimin e sponsorimit, si dhe ishin lëshuar vërtetimet e para për disa donatorë. Miratimin e ligjit në fjalë e

mirëpriti edhe kryetari i Komitetit Olimpik të Kosovës, Besim Hasani. Ai në emër të Lëvizjes Olimpikë dhe sportive ka falënderuar deputetët për votimin e tij. "Të nderuara deputete dhe deputetë, në emër të Lëvizjes Olimpikë dhe Sportive në Kosovë ju përcjell respektin dhe ju falënderoj për zotërisht!", ka thënë Hasani. Ndërsa deputeti i Kuvendit të Kosovës, Bekim Haxhiu, që ishte propozues i Ligjit për Tatimin në të Ardhurat e Korporatave, ka thënë se do të jetë këmbëngulës gjithmonë për zhvillimin e sportit të Kosovës. "Më meritoret për këtë janë sportistët tanë të cilët po arrijnë rezultate kulminante në arenat sportive dhe me sukseset e tyre i bënë të gjithë deputetët të reflektojnë për zhvillimin e sportit. Sa herë flitet për zhvillimin e sportit do të jem këmbëngulës dhe do t'i përkrahi gjithmonë e sa herë të kem mundësi", ka deklaruar Haxhiu.

Të lumtur për miratimin e ligjit janë shfaqur edhe drejtuesit e federatave sportive, trajnerët, sportistët dhe ish-sportistët. Kryetari i Federatës së Futbollit, Agim Ademi, ka vlerësuar se ky akt do t'i japë një shtytje të madhe zhvillimit të futbollit dhe sportit në përgjithësi. "Miratimi i këtij ligji nga deputetët e Kuvendit të Republikës së Kosovës i jep një shtytje të madhe zhvillimit të sportit, me theks të veçantë futbollit, i cili është sporti me shtrirjen më të gjerë dhe më i popullarizuar në vendin tonë", ka thënë Ademi, i cili me këtë rast ka rikujtuar sakrificën e madhe që kanë dhënë dona-

torët për më shumë se dy dekada vetëm për ta mbajtur gjallë sportin.

Ndërsa trajneri më i suksesshëm në Kosovë, Driton Kuka, falënderoi të gjithë deputetët që votuan pro Ligjit për Tatimin në të Ardhurat e Korporatave. Kuka vlerësoi se pas sukseseve të vazhdueshme, sportistët e merituan përkrahjen. "Urimet për kalimin e ligjit i mora nga kryetari i Kuvendit, Kadri Veseli. Faleminderit të gjithë deputetëve për votën pro ligjit. E meriton sporti, e meritojnë sportistët përkrahjen me sukseset e arritura. Sporti dhe sukseset tona janë të Kosovës, prandaj kur flitet për sport s'duhet shikuar ndryshe. Kosova, mbi të gjitha", ka shkruar Kuka në "Facebook". Kryetari i Federatës së Basketbollit të Kosovës (FBK), Arben Fetahu, është shprehur shumë i lumtur për miratimin e Ligjit për Tatimin e të Ardhurave në Korporata. "Me shpresë u hoq edhe pengesa e fundit që sportistët e të gjitha niveleve, trajnerët, punonjësit, klubet dhe federatat sportive ta gëzojnë të drejtën që ligji ua ka akorduar që para dy vjetësh e gjysmë. Tash homologëve të mi, Komitetit Olimpik të Kosovës dhe të gjithë punëtorëve sportivë në të gjitha nivelet, na mbetet të mobilizohemi, t'i konsolidojmë kapacitetet tona dhe t'u siguro-

jmë sportistëve kushte të mirëfillta për punë dhe zhvillim. Ditë të mira po vijnë për sportin e Kosovës", ka thënë Fetahu.

Ndërsa kryetari i Federatës së Hendbollit të Kosovës, Eugen Saraçini, ka deklaruar: "Urime sportiste, artiste dhe rini! Urime federata, klube, teatro, artist! Tash do të kemi mundësi të veçantë për ta zhvilluar sportin dhe kulturën".

Kadri Veseli: Nga sot nis etapë e re e mbështetjes

Kryetari i Kuvendit të Kosovës, njëherësh lider i PDK-së, Kadri Veseli, ka uruar të gjithë sportistët dhe artistët e Kosovës të cilët nga sot do të gëzojnë mbështetje më të madhe buxhetore, pas ndryshimeve përkatëse të legjislacionit për sponsorime.

Nëpërmjet një statusi në faqen e tij në "Facebook", Veseli ka uruar të gjithë sportistët dhe artistët, të cilët, siç ka thënë ai, meritojnë përkrahje të cilët po e bëjnë vendin krenar me punën dhe sukseset e tyre. "Nga sot nis një etapë e re, e përkrahjes meritore për sportistët dhe artistët tanë, të cilët çdo ditë e më shumë po na bëjnë krenarë brenda dhe jashtë vendit. Falënderoj të gjithë deputetët që votuan për harmonizimin e Ligjit për

Sponsorime në Sport dhe Kulturë, me Projektligjin për Tatimin në të Ardhurat e Korporatave", ka shkruar Veseli.

Haradinaj: Ligji për Sponsorim, etapë e re për fuqizimin e sportit në Kosovë

Kryeministri i Republikës së Kosovës, Ramush Haradinaj, e ka përshëndetur miratimin e Ligjit për Tatimin në të Ardhurat e Korporatave. Haradinaj ka vlerësuar se ky ligj e hap një etapë të re për fuqizimin e sportit dhe iu jep krahë sukseseve kulmore të sportistëve të Kosovës. "Një etapë e re shpresëdhënëse për fuqizimin e sportit në Kosovë. E përgëzoj Kuvendin që me votën e tij fuqizoi sportin dhe iu dha krahë sukseseve kulmore të sportistëve tanë, të cilët po ecin gjurmëve të Majlinda Kelmendit, duke e ngritur lart imazhin e vendit. Votimi i Ligjit për tatim mbi të ardhurat në korporata, i cili e kompletonte dhe e mundëson implementimin e Ligjit për Sponsorim, u jep mundësi bizneseve të investojnë jo vetëm në rritjen e kapitalit të tyre, por edhe në kultivimin e vlerave në sport që ngrahin talentët e rinj në përmasa ndërkombëtare", ka shkruar Haradinaj.



EPOKA E RE						Autor: GAZMEND MORINA	AFTËSIA E NJERIUT PËR TË KRIJUAR	LLOJ ZOGU KËNGËTAR	↓	FORTESË LIMIT	ERA E MIRË	SHTET I MADH NË AZI	EPOKA E RE	BASHKËT.	OLIVER NEUVILLE	FARMACI	PËREMËR PRONOR	
						QË UA MBATH KËMBËVE NGA FRIKA							HATAJA AKTORI MORINA					
						SËMUNDJE E RËNDË QË SHKAKTOHET NGA PARAZITË SHUMË TË VEGJËL (shq.)								ZULMË TËRHEQJE				
						LLOJ GJARPRI									"RISANI" IZET FETAHAJ			
						GJILANI, ARTANA			MBIEMËR CILËSOR	LETRARI CAMAJ ARIANITI (perkdh.)								EMËRIMI NË NJË POZITË
						AKTORJA CAHANI							EMËR YNI MASHKULLI NANTES					
						DJALI I VAJZËS					"N" para dy "A" KULAÇE (shq.)				"TORINO"			
						PADITËSI I SOKRATIT							DY BASHKËTINGËLLORE "IRLANDA"			OLIVIER MARTINEZ ZANORE		
EPOKA E RE						MANEKINIA SHQIPTARE HITAJ	PËRCAKTIM, PËRKUFIZIM	URANI, KRABONI	SHTET AFRIKAN (pashq.)	PJESËTAR I NJË FISI ILIRI	FORMË E TË HYRAVE SHTETËRORE (shq.) THEMBRA E KËPUCËS			SHTET AZIATIK (pashq.) DËSHIROJNË				
						SJELLJA E NJERËZISHME					ZANORE MJET I THJESHTË PUNE		AKTORI ISLAMI (shq.) ZANORE			ESTONIA, NORVEGJIA KËNGËTAR I NJOHUR AMERIKAN		
						FLETA E VOGËL, KU MJEKU SHËNON LLOJET E BARNAVE					SULM E HAPUR			UNIVERSITY OF AUCKLAND			ZANORE FIGURË E RIPRODHUAR E NJË SENDI, SHËMBËLLTYRË	
						AGIM TEJECI		LLOJ METALI LUTJE DREJTUAR ZOTIT (mysl.)			KËNGËTARJA ITALIANE PAUSINI		UGANDA POLITIKANI FINLANDEZ ... REHN		ANKESË SONDAZHI			
						KËNGËTARJA E NJOHUR SHQIPTARE NË FOTO								ALEN NURI OSAKA		NJËSIA E REZISTENCËS ELEKTRIKE FEMRAT LUFTËTARE (mit. greke)		
						BIMË SHUM-ËVJËÇARE ME TRUNG TË TRASHË			BASHKËT.	KALIBËR I TYTËS SË ARMËS QË VEPRON ME GJALLËRI				SKAJI, QOSHJA ISMET MALAJ			ALBANOLOGIA DURHAM	
						GURRA		AMPER, ALUMIN SHKRETËTIRA MË E THATË NË BOTË			DY ZANORE AUSTRIA, ISLANDA		AKTORJA AMERIKANE BASINGER FUTBOLLISTI FRANCEZ NASRI			ZHAN EDUARDSON DISIPLINË SPORTIVE		
EPOKA E RE						ZANORE I THAJ		BËRË ANKESË ANA VISI					LUMË NË SHQIPËRI TËRËSIA E ORENDIVE				BASHKËT. KËNGËTARJA ANGLEZE TANITA	
						ZEMËRIM				ORGANIZATA MAFIOZE "..... KINEZE" FARISHTA					PERËNDIA			
						QYTET SHQIPTAR NË MAL TË ZI					ANTON PASHKU	KLUB FUTBOLLI ARGJENTINAS "... LORENZO"	SOLISTJA BYTYQI VENDËSI		PEZMATIM I VESHIT U PESHOVA			
						ERMAL MAMAQI		LLOJ MOTOÇIKLETE QË PRODHOHET NË JAPONI AKTORI CRUISE (shq.)						QË S'KA TJETËR TË NGJASHËM ME TË TË LUTEM			ILAÇI	
						BASHKËT.	GOTË PREJ BAKRI KAMION I VOGËL			PEIZAZH I GJERË SPEECH AUSTRALIA PATHOLOGY						ANITA BITRI PËREMËR VETOR		
EPOKA E RE						ISH PRESIDENTI AMERIKAN XHEFERSON NJË E RESHUR					SHEGË TENI ANDERSON		ENË E MADHE PËR TË MBAJTUR QUMËSHT TANTAL					
						POTERË (sh.shq.)						MJET PËR SITJE (sh.shq.) SHKRONJA XXIV			RAST BASHKËT.			
